

**TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR  
PËR ISH-JUGOSLLAVINË**

**Lënda Nr. IT-05-87-PT**

**PROKURORJA**

**KUNDËR**

**MILLAN MILLUTINOVIQIT  
NIKOLLA SHAINOVIQIT  
DRAGOLUB OJDANIQIT  
NEBOJSHA PAVKOVIQIT  
VLADIMIR LLAZAREVIQIT  
VLASTIMIR GJORGJEVIQIT  
SRETEN LLUKIQIT**

**AKTAKUZË E PËRBASHKËT E NDRYSHUAR**

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë në bazë të autoritetit të saj që rrjedh prej Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (“Statuti i Tribunalit”) akuzon:

**MILLAN MILLUTINOVIQIN  
NIKOLLA SHAINOVIQIN  
DRAGOLUB OJDANIQIN  
NEBOJSHA PAVKOVIQIN  
VLADIMIR LLAZAREVIQIN  
VLASTIMIR GJORGJEVIQIN  
SRETEN LLUKIQIN**

për **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS** si më poshtë.

**TË AKUZUARIT**

1. **MILLAN MILLUTINOVIQI** u lind më 19 dhjetor 1942 në Beograd, Serbi. **MILLAN MILLUTINOVIQI** u diplomua në drejtësi nga Universiteti i Beogradit. Gjatë karrierës së tij politike **MILLAN MILLUTINOVIQI** pati një sërë detyrash të larta qeveritare në Serbi dhe në Republikën Federale të Jugosllavisë (“RFJ”), ndër të tjera ambasador i RFJ-së në Greqi dhe Ministër i Punëve të Jashtme të RFJ-së. **MILLAN MILLUTINOVIQI** mbeti në postin e Presidentit të Serbisë deri më 29 dhjetor 2002.

2. **NIKOLLA SHAINOVIQI** u lind më 7 dhjetor 1948 në Bor, Serbi. **NIKOLLA SHAINOVIQI** ishte anëtar i Partisë Socialiste të Serbisë (“SPS”), dhe pati disa funksione në qeverinë e Serbisë dhe në qeverinë e RFJ-së, ndër të tjera Zëvendëskryeministër i Serbisë, Kryeministër i Serbisë dhe Zëvendëskryeministër i RFJ-së. **NIKOLLA SHAINOVIQI** dha dorëheqjen nga detyra e tij si Zëvendëskryeministër i RFJ-së më 4 nëntor 2000 ose përpara kësaj date, pas formimit të një qeverie të re federale.

3. **DRAGOLUB OJDANIQI** u lind më 11 qershor 1941 në fshatin Ravni afër Uzhices në Serbi. Në 1992 **DRAGOLUB OJDANIQI**, si Komandant i Korpusit të Uzhices të Ushtrisë Jugosllave (“UJ”), mori pjesë në operacionet ushtarake në Bosnjën lindore gjatë luftës në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës (“Bosnja dhe Hercegovina”). Në 1996 **DRAGOLUB OJDANIQI** u bë Zëvendësshëf i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. **DRAGOLUB OJDANIQI** u emërua Ministër Federal i Mbrojtjes më 15 shkurt 2000 dhe shërbeu në këtë detyrë deri më 3 nëntor 2000. Ai u lirua prej shërbimit ushtarak me dekret presidencial më 30 dhjetor 2000.

4. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u lind më 10 prill 1946 në fshatin Senjski Rudnik, Serbi. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** pati një sërë funksionesh në Armatën Popullore të Jugosllavisë (“APJ”). Në 1994 **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u caktua në Korpusin e Prishtinës të Forcave të Armatosura të UJ-së në Prishtinë, Kosovë, ku pati detyra të ndryshme në shtabin komandues derisa mori detyrën e komandantit të Korpusit më 9 janar 1998. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u gradua Gjenerallejtant më 21 korrik 1998. Më 25 dhjetor 1998, **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u emërua Komandant i Armatës së Tretë me dekret presidencial dhe e mbajti këtë post deri në fillim të vitit 2000. Më 31 mars 1999, ai u gradua Gjeneralkolonel. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u vlerësua për rolin e tij gjatë gjendjes së luftës në 1999 me Urdhrin e Lirisë prej Presidentit Millosheviq më 16 qershor 1999. Në shkurt 2000, **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u emërua Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së. Shërbimi i tij në UJ dhe funksioni i tij si Shef i Shtabit të Përgjithshëm përfunduan me dekret presidencial më 24 qershor 2002.

5. **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u lind në qytetin Gërçar në komunën e Babushnicës në Serbi, më 23 mars 1949. Në 1998 **Vladimir LLAZAREVIQI** u bë Shef i Shtabit të Korpusit të Prishtinës dhe, më 25 dhjetor 1998, me dekret presidencial, u emërua Komandant i Korpusit të Prishtinës. Për rolin e tij gjatë gjendjes së luftës, **Vladimir LLAZAREVIQI**, mori dy vlerësime zyrtare dhe në qershor 1999 me dekret presidencial u gradua Gjenerallejtant. Më 28 dhjetor 1999 **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u emërua Shef i Shtabit të Armatës së Tretë dhe më tej Komandant i Armatës së Tretë më 13 mars 2000. **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u gradua Gjeneralkolonel më 30 dhjetor 2000. Në fillim të vitit 2002 **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u emërua si Ndihmës për Forcat Tokësore në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së. Në gusht 2003, **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u largua nga detyra në Ushtrinë e Serbisë dhe të Malit të Zi.

6. **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** u lind në 1948 në Koznica në komunën Vlladiçin Han, Serbi. **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** ishte Ndihmësministër i Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (“MPB”) dhe Shef i Departamentit të Sigurisë Publike (“RJB”) të MPB-së (fillimisht si zëvendësues në postin e dytë) që prej 1 qershorit 1997 dhe e mbajti këtë post deri më 30 janar 2001. **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** u dekorua me Urdhrin e Flamurit Jugosllav të Klasit të Parë prej Sllobodan Millosheviqit më 7 korrik 1999.

7. **SRETEN LLUKIQI** u lind më 28 mars 1955 në komunën Vishegrad në Bosnjë dhe Hercegovinë. **SRETEN LLUKIQI** e filloi karrierën e tij në Punët e Brendshme në 1974 dhe ishte në poste të ndryshme ndër të cilat Ndihmësshëf për Detyrat e Policisë në Sekretariatën për Punë të Brendshme në Beograd, post të cilin e mori në janar 1992. Më 1 qershor 1998, **SRETEN LLUKIQI** u emërua Shef i Shtabit për Kosovën dhe Metohinë të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (“Shtabi i MPB-së”) me gradën Gjeneralmajor. Mandati i Shtabit të MPB-së u zgjat më 16 qershor 1998 dhe **SRETEN LLUKIQI** mbeti shefi i tij.

Më 12 maj 1999, **SRETEN LLUKIQI** u gradua Gjeneralejtnant me dekret të Presidentit të Republikës së Serbisë. Pas qershorit 1999, **SRETEN LLUKIQI** ishte Ndihmësshef i RJB-së dhe Shef i Administratës së Policisë Kufitare në MPB, në Beograd. Më 31 janar 2001, **SRETEN LLUKIQI** u emërua Ndihmësministër dhe Shef i RJB-së. Në këtë post ai u gradua Gjeneralkolonel.

#### **POZITA E TË AKUZUARVE**

8. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **MILLAN MILLUTINOVIQI** mbante postin e Presidentit të Serbisë, post në të cilin u zgjodh më 21 dhjetor 1997. Si President i Serbisë:

- i. **MILLAN MILLUTINOVIQI** ishte kryetar i shtetit. Ai përfaqësonte Serbinë dhe merrej me marrëdhëniet e saj me shtetet e huaja dhe organizatat ndërkombëtare.
- ii. **MILLAN MILLUTINOVIQI** ishte anëtar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes (“KLM”) të RFJ-së dhe mori pjesë në vendime mbi përdorimin e UJ-së. Ai organizoi përgatitjet për mbrojtjen e Serbisë. Në bazë të Ligjit të Mbrojtjes së RFJ-së, **MILLAN MILLUTINOVIQI**, si anëtar i KLM-së, gjithashtu ushtroi autoritet epror mbi njësitë e MPB-së në varësi të UJ-së gjatë gjendjes së rrezikut të afërt të luftës ose gjendjes së luftës.
- iii. **MILLAN MILLUTINOVIQI** në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Serbisë, kishte autoritet të kërkonte raporte prej Qeverisë së Serbisë, lidhur me çështje të juridiksionit të saj, dhe prej MPB-së për veprimtarinë e saj dhe gjendjen e sigurisë në Serbi.
- iv. **MILLAN MILLUTINOVIQI** kishte fuqi ta shpërndante Kuvendin e Republikës së Serbisë dhe bashkë me të edhe qeverinë, “varësisht prej propozimit të qeverisë mbi bazë të justifikueshme,” megjithëse kjo kompetencë ishte e zbatueshme vetëm në kohë paqeje.
- v. **MILLAN MILLUTINOVIQI**, gjatë gjendjes së shpallur të luftës apo gjendjes së rrezikut të afërt të luftës, mund të miratonte masa që normalisht ishin kompetencë e Kuvendit të Republikës së Serbisë, duke përfshirë miratimin e ligjeve; këto masa mund të përfshinin riorganizimin e qeverisë dhe të ministrive si edhe kufizimin e disa të drejtave dhe lirive.

9. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **NIKOLLA SHAINOVIQI** mbante postin e Zëvendëskryeministrit të RFJ-së. Si Zëvendëskryeministër i RFJ-së, **NIKOLLA SHAINOVIQI** ishte anëtar i qeverisë së RFJ-së, e cila ndër detyra dhe përgjegjësi të tjera, hartonte politikën e brendshme dhe të jashtme, zbatonte ligjet federale, drejtonte dhe bashkërendonte punën e ministrive federale dhe organizonte përgatitjen e mbrojtjes.

10. Në 1998, Sllobodan Millosheviqi e caktoi **NIKOLLA SHAINOVIQIN** si përfaqësuesin e tij për Kosovën. Në këtë cilësi:

- i. **NIKOLLA SHAINOVIQI** ishte Kryetar i Komandës së Përbashkët.

- ii. Një numër diplomatësh dhe zyrtarësh ndërkombëtarë të cilëve u duhej të flisnin me një zyrtar të qeverisë lidhur me ngjarjet në Kosovë adresoheshin te **NIKOLLA SHAINOVIQI**.
- iii. **NIKOLLA SHAINOVIQI** pati rol aktiv në negociatat për misionin verifikues të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (“OSBE”) dhe mori pjesë në takime të tjera të shumta lidhur me krizën në Kosovë.
- iv. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **NIKOLLA SHAINOVIQI** veprroi si ndërlidhës midis Sllobodan Milloseviqit dhe udhëheqësve të ndryshëm shqiptarë të Kosovës.

11. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **DRAGOLUB OJDANIQI** mbajti postin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, pasi ishte emëruar më 24 nëntor 1998 prej Sllobodan Milloseviqit për të zëvendësuar Gjeneralin Momçillo Perishiq. Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së:

- i. **DRAGOLUB OJDANIQI** komandoi, urdhëroi, udhëzoi, kontrolloi ose ndryshe drejtoi UJ-në, në bazë të akteve të nxjerra prej Presidentit të RFJ-së dhe sipas kërkesave për komandën e UJ-së.
- ii. **DRAGOLUB OJDANIQI** përcaktoi organizimin, planin e zhvillimit dhe formimin e komandave, njësive dhe institucioneve të UJ-së, në pajtim me karakterin dhe nevojat e UJ-së dhe në bazë të akteve të nxjerra prej Presidentit të RFJ-së.
- iii. **DRAGOLUB OJDANIQI** përcaktoi planin e rekrutimeve dhe punësimeve në UJ dhe të shpërndarjes së rekrutëve brenda UJ-së; nxorri rregullore në lidhje me stërvitjen e UJ-së; përcaktoi planin mësimor dhe kualifikimin e lartë të oficerëve ushtarakë të rregullt dhe rezervistë; dhe kreu detyra të tjera të diktuar prej ligjit.
- iv. **DRAGOLUB OJDANIQI** – ose oficerë të tjerë të autorizuar prej tij – caktoi oficerë, nënoficerë dhe ushtarë, dhe gradoi nënoficerë, oficerë rezervistë dhe oficerë deri në gradën kolonel.
- v. **DRAGOLUB OJDANIQI** kreu përgatitjet për mobilizimin ushtarak të qytetarëve dhe të UJ-së, bashkëpunoi me MPB-në dhe Ministrinë e Mbrojtjes së RFJ-së për mobilizimin e organeve dhe njësive të MPB-së; mbikëqyri dhe propozoi masa për zgjidhjen e problemeve të hasura, dhe informoi qeverinë e RFJ-së dhe Këshillit të Lartë të Mbrojtjes mbi zbatimin e mobilizimit.
- vi. **DRAGOLUB OJDANIQI** në bazë të Ligjit të Mbrojtjes të RFJ-së, ushtroi autoritet komandues mbi njësitë e MPB-së dhe mbi njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile dhe grupe të tjera të armatosura në varësi të Armatës së Tretë të UJ-së gjatë gjendjes së rrezikut të afërt të luftës ose gjendjes së luftës. Rreziku i afërt të luftës u shpall më 23 mars 1999, dhe gjendja e luftës më 24 mars 1999.
- vii. **DRAGOLUB OJDANIQI** emëroi kryetarët, gjykatësit, prokurorët, zëvendësit dhe sekretarët e gjykatave disiplinore ushtarake.

12. Më 25 dhjetor 1998, **NEBOJSHA PAVKOVIQI** u emërua Komandant i Armatës së Tretë me dekret presidencial. Ai e filloi detyrën si Komandant i Armatës së Tretë më 13 janar 1999 dhe vazhdoi ta mbante këtë post gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë. Si Komandant i Armatës së Tretë:

- i. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** komandonte të gjitha njësitë e Armatës së Tretë të Ushtrisë Jugosllave dhe njësitë e caktuara pranë Armatës së Tretë të UJ-së, në zonën e përgjegjesisë së saj. Ai mbante përgjegjësi të plotë për operacionet e kryera prej njësive të Armatës së Tretë të UJ-së, njësive të caktuara pranë Armatës së Tretë dhe për punën e Shtabit komandues të Armatës së Tretë. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** ushtroi autoritetin e tij si Komandant i Armatës së Tretë të UJ-së në lidhje me ngjarjet në Kosovë nga janari 1999 deri në qershor 1999.
- ii. **NEBOJSHA PAVKOVIQI** ushtroi autoritet komandues ose kontroll mbi njësitë e MPB-së të varura prej, ose që vepronin në bashkëpunim ose bashkërendim me njësitë e Armatës së Tretë të UJ-së si edhe mbi njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile dhe grupeve të tjera të armatosura, në bazë të Ligjit të Mbrojtjes të RFJ-së, dhe nëpërmjet strukturave dhe mekanizmave të përbashkëta komanduese dhe bashkërenduese.

13. **VLADIMIR LLAZAREVIQI** u emërua Komandant i Korpusit të Prishtinës të Armatës së Tretë të UJ-së në dhjetor 1998. Ai e mori komandën jo më vonë se 6 janar 1999 dhe vazhdoi ta mbante këtë post gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë. Si Komandant i Korpusit:

- i. **VLADIMIR LLAZAREVIQI** komandonte të gjitha njësitë e Korpusit të Prishtinës të Armatës së Tretë të UJ-së dhe njësitë e caktuara pranë Korpusit në zonën e përgjegjesisë së tij. Ai mbante përgjegjësi të plotë për operacionet e kryera prej njësive të Korpusit të Prishtinës të UJ-së, njësive të caktuara pranë Korpusit të Prishtinës, dhe për punën e Shtabit Komandues të Korpusit të Prishtinës.
- ii. **VLADIMIR LLAZAREVIQI** ushtroi autoritet komandues ose kontroll mbi njësitë e MPB-së të varura prej, ose që vepronin në bashkëpunim ose bashkërendim me Korpusin e Prishtinës të Armatës së Tretë të UJ-së si edhe mbi njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile dhe grupe të tjera të armatosura, në bazë të Ligjit të Mbrojtjes të RFJ-së, dhe nëpërmjet strukturave dhe mekanizmave të përbashkëta komanduese dhe bashkërenduese.

14. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** ishte Ndihmësministër dhe Shef i RJB-së. Si Ndihmësministër i MPB-së dhe Shef i RJB-së:

- i. **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** e udhëhoqi RJB-në nën drejtimin e Ministrit të Brendshëm, Vllajko Stojilkoviqi. Ai ishte përgjegjës për të gjitha njësitë dhe personelin e RJB-së në Serbi, duke përfshirë edhe Kosovën, midis 1 janarit dhe 20 qershorit 1999.

15. Gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, **SRETEN LLUKIQI** ishte Shef i Shtabit për Kosovën dhe Metohinë të Ministrisë Serbe të Punëve të Brendshme (“Shtabi i MPB-së”). Si Shef i Shtabit të MPB-së:

- i. **SRETEN LLUKIQI** planifikoi, organizoi, udhëhoqi, bashkërendoi dhe kontrolloi punën e MPB-së në Kosovë.
- ii. **SRETEN LLUKIQI** kishte detyrim të mbronte jetët e njerëzve dhe sigurinë e personave dhe të pasurisë, të parandalonte dhe zbulonte veprimet kriminale dhe të arrestonte kryesit e tyre, dhe për mbajtjen e rendit dhe të ligjit.
- iii. **SRETEN LLUKIQI** kishte komandën e operacioneve të MPB-së në Kosovë. Si oficer epror i MPB-së, **SRETEN LLUKIQI** ishte përgjegjës për njësitë e MPB-së në Kosovë midis 1 janarit dhe 20 qershorit 1999.

### **PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE**

16. Secili prej të akuzuarve është individualisht përgjegjës në lidhje me krimet për të cilët është akuzuar në këtë aktakuzë në bazë të Neneve 3, 5 dhe 7 të Statutit të Tribunalit.

17. Të akuzuarit planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen ose ndryshe ndihmuan dhe inkurajuan planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e këtyre krimeve. Në lidhje me fajësinë në planifikimin, nxitjen ose urdhërimin e kryerjes së krimeve për të cilët akuzohen, të akuzuarit vepruan të vetëdijshëm për mundësinë e konsiderueshme të kryerjes së krimeve në zbatimin e planit, urdhrit ose nxitjes. Në lidhje me fajësinë në ndihmën dhe inkurajimin, të akuzuarit vepruan duke e ditur se veprimet e kryera kontribuonin në kryerjen e krimeve.

18. Me përdorimin e fjalës “kryen” në këtë aktakuzë, Prokurorja nuk synon të sugjerojë se ndonjë prej të akuzuarve kreu fizikisht ndonjë prej krimeve për të cilët akuzohet personalisht. “Kryerja” në këtë aktakuzë, e përdorur lidhur me të akuzuarit, do të thotë pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale si bashkëkryes, drejtpërdrejtë ose tërthorazi.

19. Synimi i kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale ndër të tjera ishte ndryshimi i ekuilibrit etnik në Kosovë nëpërmjet dëbimit të një pjese të konsiderueshme të popullatës shqiptare të Kosovës nga Kosova për të siguruar kontrollin e mëtejshëm serb mbi krahinën. Dëbimi do të realizohej nëpërmjet një fushate të gjerë ose sistematike terrori dhe dhune duke përfshirë largimet, vrasjet, zhvendosjet e dhunshme dhe përndjekjet kundër popullatës shqiptare të Kosovës gjatë periudhës së aktakuzës. Për përmbushjen e këtij qëllimi kriminal, secili prej të akuzuarve, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kontribuoi ndjeshëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale duke shfrytëzuar kompetencat ligjore (*de jure*) dhe faktike (*de facto*) që kishte.

20. Kjo ndërmarrje e përbashkët kriminale filloi jo më vonë se tetor 1998 dhe vazhdoi gjatë kohës së kryerjes së krimeve të permendura në Pikat 1 – 5 të kësaj aktakuze; duke filluar më 1 janar 1999 ose rreth kësaj date dhe vazhdoi deri më 20 qershor 1999. Një numër individësh morën pjesë në këtë ndërmarrje të përbashkët

kriminale gjatë tërë ekzistencës së saj, ose ndryshe, në momente të ndryshme gjatë ekzistencës së saj, duke përfshirë **MILLAN MILLUTINOVIQIN, NIKOLLA SHAINOVIQIN, DRAGOLUB OJDANIQIN, NEBOJSHA PAVKOVIQIN, VLADIMIR LLAZAREVIQIN, VLASTIMIR GJORGJEVIQIN, SRETEN LLUKIQIN**, Sllobodan Millosheviqin dhe Vllajko Stojilkoviqin. Ndër anëtarë të tjerë ishin Radomir Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, Dragan Iliqi dhe persona të pamentifikuar të cilët ishin anëtarë të strukturave komanduese dhe bashkërenduese dhe anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë që kishin të njëjtin synim për jetësimin e qëllimit të ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Gjithashtu, dhe/ose ndryshe **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI, SRETEN LLUKIQI**, Sllobodan Millosheviqi, Vllajko Stojilkoviqi, Radomir Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, Dragan Iliqi zbatuan objektivat e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nëpërmjet anëtarëve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë, nën kontrollin e tyre në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë. Togfjalëshi “forcat e RFJ-së dhe Serbisë” në këtë aktakuzë përfshin këto forca dhe njësi: UJ, MPB (duke përfshirë njësitë e posaçme policore (“PJP”), njësitë e posaçme kundër terrorit (“SAJ”), njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së (SPB), njësitë për operacione të posaçme (“JSO”) dhe njësi të tjera të sigurimit shtetëror (“RDB”), qarkun ushtarak të Prishtinës, njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, grupe civilësh të armatosura prej UJ-së dhe/ose MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave të cilat vepronin nën kontrollin dhe autoritetin e UJ-së dhe/ose të MPB-së, dhe vullnetarë të përfshirë në njësitë e UJ-së dhe/ose MPB-së.

21. Krimet e renditura në Pikat 1 – 5 të kësaj aktakuze përfshiheshin në synimin e kësaj ndërmarrjeje të përbashkët kriminale dhe të akuzuarit kishin të njëjtin synim me bashkëkryesit e tjerë për të kryer këto krime. Ndryshe, krimet e renditura në Pikat 3-5 ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe të akuzuarit ishin të vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të mundshme të jetësimit të ndërmarrjes. Megjithëse ishin të vetëdijshëm për pasojat e parashikueshme, **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI**, vendosën të merrnin pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale. Secili prej të akuzuarve dhe pjesëmarrës të tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale gjithashtu kishin të njëjtin synim dhe gjendjen e nevojshme mendore për kryerjen e secilit prej krimeve të akuzuara në pikat 1 – 5. Mbi këtë bazë, në pajtim me Nenin 7 (1) të Statutit, secili prej të akuzuarve mbart përgjegjësi penale individuale për krimet e akuzuara në Pikat 1 – 5.

22. Ndryshe, të akuzuarit gjithashtu akuzohen si bashkëkryes të tërthortë bazuar në kontrollin e tyre të përbashkët mbi sjelljen kriminale të forcave të RFJ-së dhe Serbisë. Të akuzuarit kishin *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) për krimet e caktuara të përmendura në këtë aktakuzë, vepruan me dijeni të ndërsjellë për mundësinë e konsiderueshme se krimet do të ndodhnin si pasojë e drejtpërdrejtë e ndjekjes së synimit të përbashkët dhe ishin të vetëdijshëm për rëndësinë e rolit të tyre.

23. **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI**, duke qenë në pozita eprore, janë gjithashtu individualisht penalisht përgjegjës për veprimet ose mosveprimet e vartësve të tyre, në bazë të Nenit 7(3) të Statutit të Tribunalit për

krimet e akuzuara në Pikat 1 – 5 të kësaj aktakuze. Eprori është përgjegjës për veprimet kriminale të vartësve të vetë, në rast se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij ishin në prag të kryerjes së këtyre veprimeve apo i kishin kryer, dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve.

## **PËRMBLEDHJE E NDËRMARRJES SË PËRBASHKËT KRIMINALE**

24. Për tërë periudhën përkatëse, ekzistonte një hierarki komanduese funksionuese që garantonte se komanda dhe kontrolli fillonin nga nivelet më të larta në Beograd deri te forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në terren. Strukturat e zhvilluara komanduese dhe kontrolluese ekzistuese garantuan vëzhgim të vazhdueshëm të gjendjes në terren me anë të reagimit të menjëhershëm dhe kontaktit të vazhdueshëm midis komandantëve eprorë më të lartë dhe vartësve të tyre. Sipas Kushtetutës dhe ligjeve e rregulloreve përkatëse të RFJ-së, autoriteti më i lartë përgjegjës për çështje strategjike në lidhje me mbrojtjen e RFJ-së ishte KLM-ja që gjatë periudhës së aktakuzës përbëhej, ndër të tjerë prej, Slllobodan Millosheviqit, **MILLAN MILLUTINOVIQIT** dhe **DRAGOLUB OJDANIQIT**. KLM-ja kishte autoritet sipëror mbi UJ-në dhe organizatat e tjera të angazhuara në mbrojtjen e vendit. Gjatë gjendjes së luftës shpallur më 24 mars 1999, Komanda e Lartë u bë organi më i lartë udhëheqës ushtarako-civil. Ai kryesohej prej Slllobodan Millosheviqit dhe në të bënin pjesë edhe **MILLAN MILLUTINOVIQI** dhe **DRAGOLUB OJDANIQI**. Aty formulohej strategjia, nxirreshin udhëzime dhe komandoheshin operacionet e forcave të RFJ-së dhe Serbisë. Anëtarët e KLM-së, Komanda e Lartë dhe komanda e UJ-së ushtruan komandë dhe kontroll mbi MPB-në dhe njësitë e saj vartëse duke qenë se ligji përkatës i RFJ-së përcaktoi se në gjendjen e rrezikut të afërt të luftës (23 mars 1999) ose gjendjen e luftës (nga 24 mars 1999 deri më 26 qershor 1999) MPB-ja ishte në varësi të UJ-së kur merrte pjesë në operacione luftarake.

25. Slllobodan Millosheviq, **MILLAN MILLUTINOVIQI** dhe **NIKOLLA SHAINOVIQI**, gjithashtu ushtruan komandë mbi forcat e RFJ-së dhe Serbisë, nëpërmjet organizmave të tjera, përfshirë edhe Komandën e Përbashkët kryesuar prej **NIKOLLA SHAINOVIQIT**, e cila ishte e autorizuar të bashkërendonte punën e organeve për çështje civile me veprimtaritë e organizatave në përbërje të forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë dhe për të garantuar që ata t'i kryenin operacionet në pajtim me objektivat politike. Gjithashtu Komanda e Përbashkët ushtroi komandë faktike mbi këto organe. Ky autoritet komandues plotësoi hierarkitë e brendshme komanduese të UJ-së dhe MPB-së për të siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin. Në Komandën e Përbashkët bënin pjesë anëtarë të lartë të udhëheqjes civile, politike dhe ushtarake ndër të tjerë, **NEBOJSHA PAVKOVIQI**, komandant i Armatës së Tretë; **VLADIMIR LLAZAREVIQI**, komandant i Korpusit të Prishtinës, **SRETEN LLUKIQI**, Shef i Shtabit të MPB-së, Shefi i Komitetit të Përkohshëm Ekzekutiv (“KPE”) dhe udhëheqës të tjerë të UJ-së dhe MPB-së.

26. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë, qëllimisht dhe gjerësisht ose sistematikisht, dëbuan me dhunë dhe shpërngulën brenda vendit qindra mijëra shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre anembanë krahinës së Kosovës. Për të lehtësuar dëbimet dhe shpërnguljet, forcat e RFJ-së dhe Serbisë, qëllimisht krijuan një gjendje frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit me forcë dhe veprimeve të dhunshme.



27. Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u përfshinë në një fushatë të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike të shkatërrimit të pronave të civilëve shqiptarë të Kosovës. Kjo u arrit me granatimin e përhapur të qyteteve dhe fshatrave, djegjen dhe shkatërrimin e pronave, duke përfshirë shtëpi, ekonomi bujqësore, biznese, monumente kulturore dhe vende fetare, dhe shkatërrimin e pronave personale. Si pasojë e këtyre veprimeve të bashkërenduara, fshatra, qytete dhe rajone të tëra u bënë të pabanueshme për shqiptarët e Kosovës.

28. Përveç shkatërrimit të qëllimshëm të pronave të civilëve shqiptarë të Kosovës, forcat e RFJ-së dhe Serbisë ndërmorën veprime të gjera ose sistematike të egra dhe të dhunshme kundër civilëve shqiptarë të Kosovës për të mbajtur më tej gjendjen e frikës, për të krijuar kaos dhe një frikë të gjithanshme për jetën. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë shkuan fshat më fshat, qytet më qytet dhe rajon më rajon, duke kërcënuar dhe dëbuar popullatën shqiptare të Kosovës. Shqiptarët e Kosovës shpesh u frikësuan, u sulmuan ose u vranë para të tjerëve për të shkaktuar largimin e familjeve dhe fqinjëve të tyre. Shumë shqiptarë të Kosovës që nuk u dëbuan drejtpërsëdrejti me dhunë nga vendbanimet e tyre, ikën si pasojë e gjendjes së terrorit shkaktuar prej rrahjeve, ngacmimeve, sulmeve seksuale, arrestimeve të paligjshme, vrasjeve, granatimit dhe plaçkitjeve të kryera gjerësisht ose sistematikisht anëmbanë krahinës. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhdimisht i fyen shqiptarët e Kosovës, i poshtëruan nga ana racore dhe i nënshtruan ndaj veprimeve të tjera poshtëruese dhe formave të tjera të keqtrajtimit fizik dhe psikologjik bazuar në identitetin racor, fetar dhe politik. Të gjitha kategoritë e shoqërisë shqiptare të Kosovës u shpërngulën, duke përfshirë gra, fëmijë, të moshuar dhe të sëmurë.

29. Mijëra shqiptarë të Kosovës të cilët ikën nga shtëpitë e tyre si pasojë e sjelljes së forcave të RFJ-së dhe Serbisë dhe gjendjes së qëllimshme të terrorit që mbizotëronte në territorin e Kosovës iu bashkuan kolonave të personave që lëviznin drejt kufijve të Kosovës me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Përgjatë rrugëve drejt kalimeve kufitare, forcat e RFJ-së dhe Serbisë ishin të pranishme në postblloqe ku shqiptarët e shpërngulur të Kosovës iu nënshtruan rrahjeve të tjera, zhvatjes, grabitjes, ngacmimeve, sulmeve, arrestimeve të paligjshme dhe vrasjeve. Herë të tjera forcat e RFJ-së dhe Serbisë shoqëruan grupet e shqiptarëve të shpërngulur të Kosovës deri në kufi. Me këto metoda, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë mbajtën kontroll mbi lëvizjen e shqiptarëve të shpërngulur të Kosovës drejt kufijve. Shpesh shqiptarët e Kosovës mbërritën në kufi duke ecur në këmbë në kolona prej mijëra vetësh apo në traktorë, rimorkio dhe kamionë, si edhe në trena, autobusë ose kamionë të organizuar dhe vënë në dispozicion nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë.

30. Gjithashtu, mijëra shqiptarë të Kosovës që ikën nga shtëpitë e tyre dhe pastaj u zhvendosën forcërisht si pasojë e sjelljes së forcave të RFJ-së dhe Serbisë dhe gjendjes së përgjithshme të terrorit që mbizotëronte në territorin e Kosovës, u detyruan për ditë, javë ose muaj të kërkonin strehim në qytete dhe fshatra të tjera dhe/ose në pyje dhe male anëmbanë krahinës. Disa prej personave të shpërngulur brenda vendit, mbetën brenda krahinës së Kosovës gjatë tërë kohës që ka lidhje me këtë aktakuzë, dhe shumë persona vdiqën si pasojë e kushteve të ashpra të mottit, ushqimit të pamjaftueshëm, kujdesit të pamjaftueshëm mjekësor dhe rraskapitjes. Të tjerët më në fund kaluan kufirin e Kosovës me Shqipërinë, Maqedoninë, Malin e Zi ose kaluan kufirin krahinor midis Kosovës dhe Serbisë. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjet e shumë shqiptarëve të Kosovës të shpërngulur brenda vendit derisa në fund ata u dëbuan nga Kosova.

31. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë në një përpjekje të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike për të penguar rikthimin e shqiptarëve të dëbuar të Kosovës në shtëpitë e tyre, plaçkitën dhe bastisën pronat vetjake dhe tregtare të shqiptarëve të Kosovës, anembanë krahinës. Forcat e RFJ-së dhe Serbisë bënë kontrollë në shkallë të gjerë, kërcënuan me forcë dhe kryen veprime të dhunshme për t'iu grabitur shqiptarëve të Kosovës të holla dhe sende të çmueshme, dhe autoritetet në postat kufitare të RFJ-së iu vodhën gjerësisht ose sistematikisht shqiptarëve të Kosovës që po dëboheshin nga krahina, makina personale dhe gjësende të tjera.

32. Veç këtyre, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë konfiskuan dhe shkatërruan sistematikisht letërnjoftimet dhe targat e makinave të civilëve shqiptarë të Kosovës. Ndërkohë që shqiptarët e Kosovës u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe u dërguan drejt kufijve të Kosovës, ata u ballafaquan me kërkesat për dorëzimin e dokumenteve të identifikimit në pika të zgjedhura, gjatë rrugëtimit për në kalimet kufitare dhe në kalimet kufitare për në Shqipëri dhe Maqedoni. Këto veprime u ndërmorën për fshirjen e çdo gjurme në Kosovë të pranisë së shqiptarëve të dëbuar të Kosovës dhe për t'iu mohuar atyre të drejtën e kthimit në shtëpitë e tyre.

33. Krimet e kryera në secilën prej komunave dhe vendndodhjeve të përmendura më poshtë në paragrafët 73-78 ndoqën një vijimësi të qartë dhe u kryen prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë, që vepronin në bashkëpunim dhe bashkërendim, dhe që kryenin role plotësuese për arritjen e synimit të përbashkët.

34. Secili prej të akuzuarve mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale në mënyrat e shpjguara (për secilin të akuzuar) në paragrafët vijues. Ndryshe, secili prej të akuzuarve kontribuoi, si bashkëkryes nëpërmjet kontrollit të përbashkët, në synimin kryesor, në mënyrat e shpjguara në këta paragrafë. Gjithashtu çdo i akuzuar është përgjegjës në lidhje me fajësinë për planifikimin, urdhërimin dhe ndihmën e inkurajimin, në bazë të Nenit 7(1), dhe sipas Nenit 7(3) bazuar në faktet e parashtruara (për çdo të akuzuar) në paragrafët vijues.

#### **MILLAN MILLUTINOVIQI**

35. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 1 dhe 8, duke iu referuar atyre,

36. **MILLAN MILLUTINOVIQI** duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:

- a. Si anëtar i KLM-së dhe Komandës së Lartë dhe si pjesëmarrës në mbledhje të tjera të udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe MPB-së, ai komandoi, kontrolloi, udhëzoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë që morën pjesë në kryerjen e krimeve të përmendura në këtë aktakuzë.
- b. Si anëtar i KLM-së dhe Komandës së Lartë dhe si pjesëmarrës në mbledhje të tjera të udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe MPB-së, ai mori pjesë në planifikimin, drejtimin, bashkërendimin dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimtarive të forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të përmendura në këtë aktakuzë.

- c. Në përputhje me udhëzimet e Slllobodan Millosheviqit, **MILLAN MILLUTINOVIQI** ushtroi autoritet mbi UJ-në dhe MPB-në dhe ishte pjesëmarrës aktiv në negociatat ndërkombëtare.
- d. Si President i Serbisë, ai përdori kompetencën e tij për lëshimin e dekreteve për marrjen e masave që kontribuan më tej në kryerjen e krimeve të përmendura në Pikat 1, 2 dhe 5.
- e. Ai mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose pranoi kryerjen e krimeve gjatë 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës si anëtar i KLM-së dhe i Komandës së Lartë.
- f. Ai inkurajoi dhe legjitimoi krimet kundër shqiptarëve të Kosovës duke mosraportuar dhe/ose duke mos hetuar krimet ose krimet e supozuara kundër tyre, duke mos verifikuar akuza ose hetime të tilla, dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e forcave të RFJ-së dhe Serbisë.
- g. Ai mori pjesë në financimin e paligjshëm të veprimtarive të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë.
- h. Si anëtar i shquar i SPS-së, ai zbatoi strategji të përcaktuara prej Slllobodan Millosheviqit, duke përfshirë disiplinimin e një politikani të lartë serb i cili kundërshtoi politikën e Slllobodan Millosheviqit në Kosovë.

37. Pjesëmarrja e **MILLAN MILLUTINOVIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe Serbisë, si rrjedhim i rolit të tij në KLM dhe në Komandën e Lartë si edhe në mbledhjet e tjera të udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.
- b. Funkcionimi i duhur i raportimit në KLM dhe Komandën e Lartë prej UJ-së dhe MPB-së në 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- c. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krimet në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krimet të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- d. Dijenia e tij për përfshirjen e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në krimet e kryera në Kosovë në 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- e. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara.
- f. Periudha kohore kur janë kryer këto krimet.
- g. Mos marrja nga ana e tij e masave të arsyeshme për të parandaluar apo për të dënuar personat përgjegjës për krimet e akuzuara.
- h. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që lejonte veprime kriminale, duke përfshirë mos marrjen nga ana e tij të masave të arsyeshme për të parandaluar apo për të dënuar kryerjen e krimeve të përmendura në Pikat 1 – 5.
- i. Dijenia e tij për synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.
- j. Mosushtrimi i autoritetit të tij si Presidenti i Serbisë për të parandaluar kryerjen dhe/ose për të ndëshkuar kryesit e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.

38. Përveç autoritetit të tij ligjor (*de jure*), gjatë tërë kohës që ka lidhje me aktakuzën, **MILLAN MILLUTINOVIQI** ushtroi ndikim apo kontroll të gjerë faktik (*de facto*) mbi institucione të shumta të domosdoshme, apo të përfshirë, në kryerjen e

krimeve të pretenduara këtu. **MILLAN MILLUTINOVIQI** ushtroi ndikim apo kontroll faktik mbi funksione dhe institucione të cilat ishin formalisht nën kompetencat e Qeverisë së Serbisë dhe të Kuvendit të Serbisë dhe të krahinave të saj autonome, duke përfshirë jo vetëm MBP-në.

39. Si Presidenti i Serbisë dhe anëtar votues i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes dhe i Komandës së Lartë, dhe në përputhje me autoritetin e tij faktik, **MILLAN MILLUTINOVIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.

40. Fakti se **MILLAN MILLUTINOVIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenja e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- b. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës, duke përfshirë takimet e tij në prill 1999 me Ibrahim Rugovën dhe udhëheqësit e tjerë shqiptarë të Kosovës.
- c. Takime të tij me Slobodan Millosheviqin për planifikimit dhe konsultimit.
- d. Prania e tij në takime ku anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale bënë deklarata nëpërmjet të cilave lanë të kuptoheshin se tërë shqiptarët e Kosovës ishin kriminelë që duhej të vriteshin.
- e. Dijenja dhe miratimi i tij për largimin e zyrtarëve të lartë të MPB-së dhe të UJ-së të cilët kishin shprehur mospajtimin me politikat e Millosheviqit në Kosovë, kurse persona që mbështetën politika të tilla u emëruan në vend të tyre.
- f. Akuzat për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarët e lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- g. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së të sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- h. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së dhe të MPB-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së.
- i. Dijenja e tij se anëtarët e forave të RFJ-së dhe të Serbisë kishin fshehur krimin e vrasjes.

## DRAGOLUB OJDANIQI

41. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 3 dhe 11, duke iu referuar atyre.
42. **DRAGOLUB OJDANIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:
- a. Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm i UJ-së dhe Kryetari i Kolegiumit të UJ-së ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi UJ-në dhe njësi në varësi të saj, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
  - b. komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe/ose ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi njësi të MPB-së dhe organe të tjera në varësi të UJ-së, në bazë të Ligjit mbi Mbrojtjen e RFJ-së, gjatë gjendjes së rrezikut të afërt të luftes, gjatë gjendjes së luftës, apo duke vepruar në bashkëpunim me UJ-në.
  - c. Si anëtar i Komandës së Lartë dhe i Shtabit të Komandës së Lartë, dhe si pjesëmarrës në takime të tjera të udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së, ai mori pjesë në planifikimin, drejtimin, bashkërendimin dhe në urdhërimin e operacioneve dhe të veprimtarive e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë, në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
  - d. Kreu përgatitje për thirrje në ushtri të qytetarëve dhe mobilizimin e UJ-së; mbikqyri dhe propozoi masa për të korrigjuar probleme që haseshin gjatë këtij mobilizimi dhe informoi qeverinë e RFJ-së dhe KLM-në rreth zbatimit të tij.
  - e. Organizoi dhe mirëmbajti komunikime mes KLM-së, UJ-së dhe njësisve dhe institucioneve në varësi të drejtpërsëdrejti të dhe/ose duke vepruar në bashkëpunim me Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së.
  - f. Drejtoi, bashkërendoi, planifikoi, nxiti dhe urdhëroi operacione dhe veprimtari të UJ-së, në veçanti të Armatës së Tretë, duke përfshirë Korpusin e Prishtinës dhe forca në varësi të dhe/ose duke vepruar në bashkëpunim me UJ-në, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në Aktakuzë.
  - g. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e UJ-së dhe të forcave në varësi të saj.
  - h. Si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, ai mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shpërfilli kryerjen e krimeve nga UJ-ja dhe nga forcat në varësi të saj gjatë periudhës së aktakuzës.
  - i. Inkurajoi dhe përligji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.
  - j. Si Zëvendësshëf i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në 1998 dhe si Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së gjatë periudhës së aktakuzës, ai u përfshi në armatimin dhe trajnimin e civilëve kryesisht jo shqiptarë në njësi të mbrojtjes vendore apo të fshatrave, ndërsa fshatra kryesisht shqiptare u çarmatosën.
  - k. Ishte në dijeni për përfshirjen e vullnetarëve dhe të grupeve të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, edhe në Kosovë në vitin 1998.

43. Pjesëmarrja e **DRAGOLUB OJDANIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i cili buronte nga roli i tij si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe si kryetari i Kolegiumit të UJ-së, si anëtar i Komandës së Lartë dhe të Shtabit të Komandës së Lartë, si dhe nga takimet e tjera të udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.
- b. Funkionimi i duhur i sistemeve të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- c. Dijenia e tij mbi ngjarjet në Kosovë si rrjedhojë e pozitës së pozicionit të tij si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, si kryetari i Kolegiumit të UJ-së, si anëtar i Komandës së Lartë dhe të Shtabit të Komandës së Lartë, si dhe nga tërë sistemet e raportimit të atyre organeve dhe nga raportet e mediave.
- d. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- e. Dijenia e tij mbi përfshirjen, në veçanti, të UJ-së dhe të njësisve në varësi të saj në krimet e akuzuara në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- g. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Tretë dhe të Korpusit të Prishtinës dhe të njësisve në varësi të tij.
- h. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- i. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe ndëshkuar personat përgjegjëse për krimet e akuzuara.
- j. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- k. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.
- l. Përfshirja e tij në bisedimet për krimet e kryera në Kosovë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke përfshire takimet e udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

44. Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe si anëtar i Komandës së Lartë dhe Shtabit të Komandës së Lartë, **DRAGOLUB OJDANIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi UJ-në, qarkun ushtarak të Prishtinës, njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, JSO-në, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në UJ dhe në MPB) dhe grupe civilësh të armatosur prej UJ-së dhe/ose MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e UJ-së dhe/ose të MPB-së.

45. Fakti se **DRAGOLUB OJDANIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi

dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- b. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës.
- c. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës ("KDOM") dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian ("EUMM"), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarët e lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosovës ("KVM").
- d. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- e. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së.
- f. Përfshirja e tij në bisedimet për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe nga MPB-ja, duke përfshirë takimet e udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

#### **NIKOLLA SHAINOVIQI**

46. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 2 dhe 10, duke iu referuar atyre.

47. **NIKOLLA SHAINOVIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:

- a. Si Zëvendëskryerministri i RFJ-së me përgjegjësi për Kosovën, ai ushtroi autoritetin e Sllobodan Millosheviqit lidhur me Kosovën, duke përfshirë autoritet mbi UJ-në, MPB-në dhe organe civile.
- b. Si Zëvendëskryerministri i RFJ-së me përgjegjësi për Kosovën, ai mori udhëzime nga Sllobodan Millosheviqi të cilat ai i zgjeroi dhe ua kaloi UJ-së dhe MPB-së, edhe drejtpërdrejtë edhe nëpërmjet Komandës së Përbashkët.
- c. Si Shefi i Komandës së Përbashkët, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- d. Ai mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimtarive të forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të përmendura në këtë aktakuzë.
- e. Ai mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e UJ-së dhe të forcave në varësi të saj.

- f. Si Shefi i Komandës së Përbashkët, ai mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shpërfilli kryerjen e krimeve nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjatë vitit 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- g. Ishte në dijeni dhe miratoi përfshirjen e vullnetarëve dhe të grupeve të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, edhe në Kosovë në vitin 1998.
- h. Inkurajoi dhe përligji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos-hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.
- i. Si Shefi i Komandës së Përbashkët, ai u përfshi në armatimin dhe trajnimin e civilëve kryesisht jo shqiptarë në njësi të mbrojtjes vendore apo të fshatrave, ndërsa fshatra kryesisht shqiptare u çarmatosën.
- j. Shprehu mendimin se në Kosovë duhej arritur një barazpeshim më i mirë demografik midis serbëve dhe shqiptarëve.
- k. Mori pjesë në financimin e paligjshëm të veprimtarive të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë.

48. Pjesëmarrja e **NIKOLLA SHAINOVIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë si Shefi i Komandës së Përbashkët.
- b. Autoriteti i tij mbi UJ-në dhe MPB-në në përputhje me udhëzimet e Slllobodan Millosheviqit.
- c. Funkcionimi i duhur i sistemeve të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- d. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- e. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- f. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së forca të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë.
- g. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- h. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar personat përgjegjëse për krimet e akuzuara.
- i. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- j. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.
- k. Ushtrimi i autoritetit të tij mbi tërë zyrtarët e tjerë të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, nëpërmjet të cilit u informua për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, me anë të sistemeve të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së, të mediave, dhe të drejtimit të tij të mbledhjeve me UJ-në, MPB-në, zyrtarë të lartë civilë, dhe Komandës së përbashkët dhe të KPE-së.



- l. Informacioni që mori nga anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për ngjarjen e Reçakut më 15 janar 1999 dhe pjesëmarrja e tij në takimin ku u diskutua për një përgjigje të mundshme ndaj ngjarjes së Reçakut.
- m. Përfshirja e tij në bisedimet për krimet e kryera në Kosovë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke përfshire takimet e udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

49. Si Zëvendëskryeministër, përfasqësues i Slllobodan Millosheviqit për tërë çështjet e Kosovës, dhe si Shef i Komandës së Përbashkët, **NIKOLLA SHAINOVIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi UJ-në dhe MPB-në, duke përfshirë Armatën e Tretë, Korpusin e Prishtinës, njësi të tjera të UJ-së të dislokuara në Kosovë, qarkun ushtarak, njësi ushtarako-territoriale, njësi të mbrojtjes civile, njësi të ruajtjes civile, njësi të MPB-së të dislokuara në Kosovë (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, JSO-në, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në) dhe grupe civilësh të armatosur prej UJ-së dhe/ose MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e UJ-së dhe/ose të MPB-së. Në mënyrë faktike (*de facto*) **NIKOLLA SHAINOVIQI** ushtroi autoritet edhe mbi **DRAGOLUB OJDANIQIN**, Vlajko Stojilkoviqin dhe vartësit e tyre në bazë të udhëzimeve nga Slllobodan Millosheviqi.

50. Fakti se **NIKOLLA SHAINOVIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumta, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi kryerjen e krimeve nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në 1998 të cilën ai e fitoi si anëtar në disa misione të RFJ-së në Kosovë në vitin 1998 për të mbledhur informacion.
- b. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, dhe në veçanti vullnetaë dhe njësi vullnetare, do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- c. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës, shumë prej të cilëve ai kishte takuar personalisht.
- d. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarët e lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- e. Akuza të tilla u ngritën nga KVM-ja, në lidhje me të cilin ai veproi si kryetar i Komisionit të Bashkëpunimit të RFJ-së.
- f. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botë, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- g. Dijenia e tij për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e

raportimit të UJ-së dhe të MPB-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së në Komandën e Lartë dhe në KPE-në.

- h. Përfshirja e tij në diskutime për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe MPB-ja, duke përfshirë informacionin që mori për ngjarjen e Reçakut më 15 janar 1999, në një mbledhje në vitin 1998 ku një anëtar i lartë i UJ-së tregoi se në Kosovë ishte përdorur forcë e tepërt, dhe në takime me udhëheqjen e lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

## **NEBOJSHA PAVKOVIQI**

51. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 4 dhe 12, duke iu referuar atyre.

52. **NEBOJSHA PAVKOVIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:

- a. Si komandant i Armatës së Tretë, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi Armatën e Tretë, duke përfshirë Korpusin e Prishtinës dhe njësi në varësi, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- b. Si anëtar i Komandës së Përbashkët, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi Armatën e Tretë, duke përfshirë Korpusin e Prishtinës dhe njësi në varësi ose në bashkëpunim me UJ-në, të cilët u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- c. Si komandant i Korpusit të Prishtinës në 1998 dhe si komandant i Armatës së Tretë gjatë periudhës së aktakuzës, ai u përfshi në armatimin dhe trajnimin e civilëve kryesisht jo shqiptarë në njësi të mbrojtjes vendore apo të fshatrave, ndërsa fshatra kryesisht shqiptare u çarmatosën.
- d. Drejtoi, bashkërendoi, planifikoi, nxiti dhe urdhëroi operacionet dhe veprimtaritë e Armatës së Tretë, duke përfshirë Korpusin e Prishtinës dhe njësi në varësi ose në bashkëpunim me UJ-në, të cilët u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- e. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e UJ-së dhe të forcave në varësi të saj.
- f. Mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shpërfilli kryerjen e krimeve nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë gjatë 1998 si komandant i Korpusit të Prishtinës dhe si komandant i Armatës së Tretë gjatë periudhës së aktakuzës.
- g. Inkurajoi dhe përligji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos raportuar ose mos hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e forcave të UJ-së dhe të forcave në varësi të saj.
- h. Ishte në dijeni për përfshirjen e vullnetarëve dhe të grupeve të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, si edhe në Kosovë në vitin 1998.

53. Pjesëmarrja e **NEBOJSHA PAVKOVIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij brenda UJ-së, si komandant i Armatës së Tretë, mbi Korpusin e Prishtinës dhe forcat në varësi të tij.
- b. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, si anëtar i Komandës së Përbashkët.
- c. Funkcionimi i duhur i sistemeve të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- d. Dijenia e tij mbi ngjarjet në Kosovë e fituar nga pozicioni i tij si Shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, si kryetari i Kolegiumit të UJ-së, si anëtar i Komandës së Lartë dhe të Shtabit të Komandës së Lartë, si dhe nga tërë sistemet e raportimit në këto organe dhe nga raportet e mediave.
- e. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Dijenia e tij mbi përfshirjen, në veçanti, të Korpusit të Prishtinës dhe të njësisve në varësi të tij në krimet e akuzuara në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- g. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- h. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Tretë dhe, në veçanti, të Korpusit të Prishtinës.
- i. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- j. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar personat përgjegjëse për krimet e akuzuara.
- k. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- l. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.
- m. Përfshirja e tij në bisedimet për krimet e kryera në Kosovë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke përfshirë takimet e udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

54. Si komandant i Armatës së Tretë, **NEBOJSHA PAVKOVIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi Armatën e Tretë, Korpusin e Prishtinës, njësi të tjera të UJ-së të dislokuara në Kosovë, qarkun ushtarak të Prishtinës, njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë në varësi ose në bashkëpunim me UJ-në (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, JSO-në, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në) dhe grupe civilësh të armatosur prej UJ-së dhe/ose MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e UJ-së dhe/ose të MPB-së.

55. Fakti se **NEBOJSHA PAVKOVIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi gjasën se njësitë e UJ-së do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- b. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës.
- c. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të FRJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarët e lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- d. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- e. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së në Komandën e Përbashkët.
- f. Përfshirja e tij në bisedimet për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe nga MPB-ja, duke përfshirë takimet e udhëheqjes më të lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

#### **VLADIMIR LLAZAREVIQI**

56. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 5 dhe 13, duke iu referuar atyre.
57. **VLADIMIR LLAZAREVIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:
  - a. Si komandant i Korpusit të Prishtinës, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontrollin efektiv mbi Korpusin e Prishtinës dhe të forcave në varësi të tij, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
  - b. Si anëtar i Komandës së Përbashkët, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi Armatën e Tretë, duke përfshirë Korpusin e Prishtinës dhe forcat në varësi ose në bashkëpunim me UJ-në, të cilët u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
  - c. Drejtoi, bashkërendoi, planifikoi, nxiti dhe urdhëroi operacione dhe veprimtari të Armatës së Tretë dhe forcave në varësi ose në bashkëpunim me UJ-në, të cilët u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
  - d. Mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shpërfilli kryerjen e krimeve nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë.
  - e. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e Korpusit të Prishtinës dhe të forcave në varësi të tij.

- f. Inkurajoi dhe përlegji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e Korpusit të Prishtinës dhe të forcave në varësi të tij.
- g. Ishte në dijeni mbi përfshirjen e vullnetarëve dhe të grupeve të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, edhe në Kosovë në vitin 1998.

58. Pjesëmarrja e **VLADIMIR LLAZAREVIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e Korpusit të Prishtinës dhe të forcave në varësi të tij, si komandant i Korpusit të Prishtinës.
- b. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, si anëtar i Komandës së Përbashkët.
- c. Funkcionimi i duhur i sistemeve të raportimit të UJ-së dhe të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- d. Dijenia e tij mbi ngjarjet në Kosovë e fituar nga pozicioni i tij si komandanti i Korpusit të Prishtinës dhe nga tërë sistemet e raportimit të atyre njësive dhe nga raportet e mediave.
- e. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Dijenia e tij mbi përfshirjen, në veçanti, të Korpusit të Prishtinës dhe të njësive në varësi të tij në krimet e akuzuara në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- g. Dijenia e tij mbi gjasën se forcat e RFJ-së dhe Serbisë do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- h. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së Korpusit të Prishtinës.
- i. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- j. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe ndëshkuar personat përgjegjës për krimet e akuzuara.
- k. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- l. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.

59. Si komandanti i Korpusit të Prishtinës, **VLADIMIR LLAZAREVIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi njësitë përbërëse të Korpusit të Prishtinës, njësi të tjera të UJ-së të dislokuara në Kosovë në varësi të Korpusit të Prishtinës, qarkun ushtarak të Prishtinës, njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë në varësi të UJ-së (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, JSO-në, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në MPB-në dhe në UJ-në) dhe grupe civilësh të armatosura prej UJ-së dhe/ose MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e UJ-së dhe/ose të MPB-së.

60. Fakti se **VLADIMIR LLAZAREVIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi gjasën se Korpusi i Prishtinës dhe njësi në varësi të tij do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- b. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës.
- c. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të RFJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarët e lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- d. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- e. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së në Komandën e Përbashkët.

#### **VLASTIMIR GJORGJEVIQI**

61. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 6 dhe 14, duke iu referuar atyre.

62. **VLASTIMIR GJORGJEVIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:

- a. Si Zëvendësministri i MPB-së dhe Shefi i RJB-së dhe si anëtar i Kolegiumit të MPB-së, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi tërë njësitë e RJB-së dhe të njërive në varësi të tyre në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- b. Si anëtar i Komandës së Përbashkët, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi ose ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë në Kosovë.
- c. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimtarive të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë, në veçanti të RJB-sa dhe të njërive në varësi të saj.
- d. Bashkë me Stojilkoviçin e të tjerë, ai kishte një rol udhëheqës në planifikimin, nxitjen urdhërimin dhe zbatimin e programit të fshehtë

- së krimit të vrasjes nga anëtarët e RJB-së dhe të forcave në varësi të saj, në bashkërendim me persona në RDB dhe në UJ.
- e. Si Zëvendësministër i MPB-së dhe Shefi i RJB-së, ai mbeshteti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shperfilli kryerjen e krimeve gjatë 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
  - f. Përfshiu vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, edhe në Kosovë në vitin 1998.
  - g. Inkurajoi dhe përligji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e MPB-së dhe të njësive në varësi të saj.
  - h. Si Zëvendësministër i MPB-së dhe Shefi i RJB-së, dhe si anëtar i Komandës së Përbashkët, u përfshi në armatimin dhe trajnimin e civilëve kryesisht jo shqiptarë në njësi të mbrojtjes vendore apo të fshatrave, ndërsa fshatra kryesisht shqiptare u çarmatosën.

63. Pjesëmarrja e **VLASTIMIR GJORGJEVIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, në veçanti mbi MPB-në dhe njësi në varësi të saj, nga roli i tij në Komandën e Përbashkët.
- b. Autoriteti i tij mbi RJB-në dhe mbi njësi në varësi të saj në Kosovë, si Zëvendësministër i MPB-së dhe Shefi i RJB-së.
- c. Funkcionimi i duhur i sistemeve të raportimit të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- d. Dijenia e tij mbi ngjarjet në Kosovë e fituar nga roli i tij në Komandën e Përbashkët dhe nga pozicioni i tij si Zëvendësministër i MPB-së dhe Shefi i RJB-së dhe nga tërë linjat e raportimit të njësive të RJB-së, dhe nga raportet e mediave.
- e. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Dijenia e tij mbi përfshirjen, në veçanti, të RJB-së dhe të njësive në varësi të saj në krimet e akuzuara në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- g. Dijenia e tij mbi gjasën se MPB-ja dhe njësi në varësi të saj, dhe në veçanti vullnetarë të përfshirë në MPB-në, do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- h. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së RJB-së dhe njësive në varësi të saj.
- i. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- j. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar personat përgjegjëse për krimet e akuzuara.
- k. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- l. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.

64. Si Zëvendësministër i MPB-së dhe Shefi i RJB-së, **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve në RJB-në) dhe njësitë në varësi ose në bashkëpunim me MPB-në, duke përfshirë njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, dhe grupe civilësh të armatosur prej MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e UJ-së dhe/ose të MPB-së.

65. Fakti se **VLASTIMIR GJORGJEVIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi krimet e kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998, e fituar nga qëndrimi i tij në Kosovë në 1998 me njësitë e MPB-së.
- b. Dijenia e tij mbi gjasën se njësi të MPB-së dhe në veçanti vullnetarë dhe njësi vullnetarësh për të cilët ai dinte se kishin kryer krime të rënda në situata të tjera të tendosjes etnike, do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- c. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës.
- d. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të FRJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarëve të lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- e. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- f. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së dhe nga takimet e Komandës së Përbashkët dhe të KPE-së.
- g. Përfshirja e tij në ngjarjen e Reçakut, duke përfshirë njoftimin e tij anëtarëve të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale se atje ishin vrarë terroristë, para kryerjes së ndonjë hetimi.
- h. Përfshirja e tij në diskutime për krimet e kryera në Kosovë nga UJ-ja dhe MPB-ja, duke përfshirë në takime me udhëheqjen e lartë civile, të UJ-së dhe të MPB-së.

#### SRETEN LLUKIQI

66. Prokuroria riparaqet dhe përfshin paragrafët 7 dhe 15, duke iu referuar atyre.



67. **SRETEN LLUKIQI**, duke vepruar individualisht dhe/ose në bashkëpunim me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mori pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, ndër të tjera, në këto mënyra:

- a. Si Shefi i Shtabit të MPB-së ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi MPB-në dhe njësi në varësi të saj në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë.
- b. Si anëtar i Komandës së Përbashkët, ai komandoi, kontrolloi, drejtoi dhe ndryshe ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë në Kosovë.
- c. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e operacioneve dhe veprimtarive të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë, të cilat u përfshinë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë, në veçanti të MPB-së dhe të njësive në varësi të saj.
- d. Mori pjesë në planifikimin, nxitjen dhe urdhërimin e fshehjes së krimit të vrasjes nga anëtarët e MPB-së dhe të njësive në varësi të saj.
- e. Si Shefi i Shtabit të MPB-së, ai mbështeti, nxiti, lehtësoi, inkurajoi dhe/ose shpërfilli kryerjen e krimeve gjatë 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Inkurajoi dhe përligji krimet e kryera kundër shqiptarëve të Kosovës duke mos raportuar dhe/ose mos hetuar krimet ose krimet e pretenduara kundër tyre, duke mos kontrolluar akuzat dhe/ose hetimet; dhe/ose duke mos ndëshkuar ose mos disiplinuar anëtarët e MPB-së dhe të njësive në varësi të saj.
- g. Përfshirja e tij si Shef i Shtabit të MPB-së në armatimin dhe trajnimin e civilëve kryesisht jo shqiptarë në njësi të mbrojtjes vendore apo të fshatrave, ndërsa fshatra kryesisht shqiptare u çarmatosën.
- h. Ishte në dijeni, dhe miratoi përfshirjen e vullnetarëve dhe të grupeve të vullnetarëve në UJ-në dhe në MPB-në, duke përfshirë ato grupe që akuzoheshin për përfshirjen në krime të rënda kundër civilëve në konflikte të tjera, edhe në Kosovë në vitin 1998.

68. Pjesëmarrja e **SRETEN LLUKIQIT** në krimet e akuzuara është gjithashtu dhe ndryshe i vetmi përfundim që mund të nxirret prej fakteve të mësipërme si edhe prej faktorëve të tjerë:

- a. Autoriteti i tij mbi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, në veçanti mbi MPB-në dhe njësi në varësi të saj, nga roli i tij ne Komandën e Përbashkët.
- b. Autoriteti i tij mbi MPB-në dhe mbi njësi në varësi të saj në Kosovë, si Shef i Shtabit të MPB-së.
- c. Funkcionimi i duhur i sistemeve të raportimit të MPB-së në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- d. Dijenia e tij mbi ngjarjet në Kosovë e fituar nga pozicioni i tij si Shefi i Shtabit të MPB-së dhe nga tërë sistemet e raportimit në ato njësi, dhe nga raportet e mediave.
- e. Dijenia e tij mbi krimet në Kosovë të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.
- f. Dijenia e tij mbi përfshirjen, në veçanti, të MPB-së dhe të njësive në varësi të saj në krimet e akuzuara në vitin 1998 dhe gjatë periudhës së aktakuzës.

- g. Dijenia e tij mbi gjasën se MPB-ja dhe njësi në varësi të saj do të kryenin krime në Kosovë gjatë periudhës së aktakuzës, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- h. Mënyra e përhapur dhe sistematike e krimeve të akuzuara në zonën e përgjegjësisë së Shtabit të MPB-së.
- i. Periudha kohore gjatë së cilës u kryen këto krime.
- j. Mosmarrja e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar personat përgjegjëse për krimet e akuzuara.
- k. Roli i tij në krijimin e një mjedisi që mundësoi sjelljen kriminale, duke përfshirë mosmarrjen e masave të arsyeshme për të parandaluar dhe të ndëshkuar kryerjen e krimeve të akuzuara sipas Pikave 1 deri 5.
- l. Dijenia e tij mbi synimin e personave në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të kryer krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.

69. Si Shefi i Shtabit të MPB-së, **SRETEN LLUKIQI** ushtroi autoritet komandues dhe/ose kontroll efektiv mbi njësitë e MPB-së të dislokuara në Kosovë (duke përfshirë PJP-në, SAJ-në, njësitë e rezervistëve policorë, personelin e sekretariatit të MPB-së, njësi të JSO-së dhe të RDB-së, dhe vullnetarë dhe grupe të vullnetarëve të përfshirë në MPB-në), si dhe njësitë në varësi ose në bashkëpunim me MPB-në, duke përfshirë njësitë ushtarako-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile, njësitë e ruajtjes civile, dhe grupe civilësh të armatosur prej MPB-së që formuan njësi të mbrojtjes së fshatrave nën komandën e MPB-së.

65. Fakti se **SRETEN LLUKIQI** e kishte *mens rea* (gjendjen mendore kriminale) të domosdoshme për fajësinë sipas Neneve 7(1) dhe 7(3) bazohet mbi dhe/ose është i vetmi përfundim që mund të nxirret prej faktorëve të shumtë, duke përfshirë faktorët e lartëpërmendur dhe faktorët e mëposhtëm:

- a. Dijenia e tij mbi gjasën se njësi të MPB-së do të kryenin krime në Kosovë, e fituar nga burimet e shumta, që raportuan gjerësisht, mbi akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1998.
- b. Këto akuza u ngritën publikisht dhe në mënyrë të dukshme, ndër të tjerë, nga diplomatët e huaj, nga Kombet e Bashkura, nga OSBE-ja, nga organizatat e të drejtave të njeriut, nga mediat e brendshme dhe të jashtme, dhe nga shqiptarët e Kosovës.
- c. Akuza për krime të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rezultuan, ndër të tjera, në krijimin e Misionit Vëzhgues Diplomatik të Kosovës (“KDOM”) dhe të Misionit Monitorues të Bashkimit Evropian (“EUMM”), si dhe në negociata intensive në Beograd në tetor 1998 (me përfshirjen e udhëheqjes civile të FRJ-së dhe të Serbisë, dhe zyrtarëve të lartë të MPB-së dhe të UJ-së), gjë që çoi, ndër të tjera, në Misionin Verifikues të Kosoves (“KVM”).
- d. Akuza të tilla u bënë të njohura në tërë botën, edhe në RFJ, dhe shërbyen si arsye për shpalljen nga ana e NATO-së e sulmeve ajrore kundër RFJ-së, pavarësisht pajtimit ose mospajtimit me këto arsye.
- e. Ishte i informuar për zhvendosjen masive të shqiptarëve të Kosovës dhe për kryerjen e krimeve të tjera të shumta, ndër të tjera, nga sistemet e raportimit të UJ-së, nga mediat dhe nga takimet e tij me zyrtarët e lartë të UJ-së dhe të MPB-së në Komandën e Përbashkët.

## AKUZA

71. Prokurorja akuzon secilin prej të akuzuarve për **Krime kundër Njerëzimit** dhe **Shkelje të Ligjeve ose Zakoneve të Luftës** siç parashtrohet më poshtë:

### **PIKA 1**

#### **DËBIMI**

72. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 16-70, duke iu referuar atyre.

73. Duke filluar nga 1 janari 1999 apo rreth kësaj date e deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo përkrahjen e **MILLAN MILLUTINOVIQIT, NIKOLLA SHAINOVIQIT, DRAGOLUB OJDANIQIT, NEBOJSHA PAVKOVIQIT, VLADIMIR LLAZAREVIQIT, VLASTIMIR GJORGJEVIQIT,** dhe **SRETEN LLUKIQIT** kryen veprimet e përshkruara në paragrafet 24 deri në 33, duke shkaktuar dëbimin e dhunshëm të rreth 800 000 shqiptarëve civilë të Kosovës. Për kryerjen më lehtë të këtyre dëbimeve dhe shpërnguljeve, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëllimisht krijuan një atmosferë frike dhe shtypjeje nëpërmjet përdorimit të forcës, kërcënimit me forcë dhe veprimeve të dhunshme, si përshkruhet më lart në paragrafet 24 deri në 33. Anëmbanë Kosovës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht granatuan qytete dhe fshatra, dogjën shtëpi dhe ferma, dëmtuan dhe shkatërruan institucione kulturore dhe fetare të shqiptarëve të Kosovës, vranë shqiptarë civilë kosovarë dhe persona të tjera që nuk morën pjesë aktive në luftime, dhe kryen sulme seksuale mbi gra shqiptare të Kosovës. Këto veprime u ndërmorën në të gjitha viset e Kosovës dhe këto mjete dhe metoda të qëllimshme u përdorën anëmbanë krahinës, duke përfshirë këto komuna:

a. Rahovec: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Celinë me tanke dhe autoblanda. Pasi granatuan fshatin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat dhe sistematikisht plaçkitën dhe grabitën çdo artikull me vlerë nga shtëpitë, iu vunë zjarr shtëpive dhe dyqaneve dhe shkatërruan xhaminë e vjetër. Shumica e fshatarëve shqiptarë të Kosovës kishin ikur në një pyll të afërt para ardhjes së ushtrisë dhe policisë. Më 28 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë detyruan mijëra njerëz që ishin strehuar në pyll të dilnin prej aty. Burrat u ndanë nga gratë, u rrahën, u plaçkitën, dhe atyre ua morën të gjitha letërnjoftimet. Pastaj burrat u detyruan të marshonin me këmbë për në Prizren dhe më në fund u detyruan të shkonin në Shqipëri.

(i) Më 25 mars 1999, një grup i madh shqiptarësh të Kosovës shkoi në një mal afër fshatit Nagafc, gjithashtu në komunën e Rahovecit, për t'u shpëtuar prej sulmeve mbi fshatrat përreth. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rrethuan dhe të nesërmen i urdhëruan të 8,000 njerëzit që kishin kërkuar strehim në mal, të largoheshin. Shqiptarët kosovarë u detyruan të shkonin në një shkollë aty afër dhe pastaj u shpërndanë me forcë nëpër fshatrat përreth. Pas tri apo katër ditësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatra, shkuan shtëpi më shtëpi dhe urdhëruan njerëzit të dilnin jashtë. Më në fund, këta njerëz u kthyen me forcë në shtëpi dhe u urdhëruan që të mos dilnin. Më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të granatonin fshatrat, duke vranë një numër njerëzish që po flinin nëpër traktorë dhe vetura. Ata që mbetën gjallë u nisën drejt kufirit me Shqipërinë. Kur arritën në kufi fshatarëve ua morën të gjitha letërnjoftimet. Gjatë dëbimeve, në tërë komunën e Rahovecit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në mënyrë sistematike dogjën shtëpi, dyqane, monumente kulturore

dhe objekte fetare që u takonin shqiptarëve kosovarë. Disa xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhamitë e Bellacërkës, Brestofcit, Krushës së Madhe, dhe të tjera.

b. Prizren: Më 25 mars 1999, fshati Piranë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë me tanke dhe lloj-lloj automjeteve ushtarake. Fshati u granatua dhe një numër banorësh u vranë. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat dhe i dogjën shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës. Pas sulmit, fshatarët e mbetur u larguan nga Pirana dhe shkuan në fshatrat përreth. Në fshatin Landovicë, një xhami e vjetër u dogj dhe u dëmtua rëndë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Disa prej shqiptarëve të Kosovës, që po iknin në drejtim të Sërbicës, u vranë apo u plagosën nga snajperët. Më pas, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj filluan një ofensivë në rrethinën e Sërbicës, duke granatuar fshatrat Reti e Ulët, Reti, dhe Randobravë. Fshatarët shqiptarë kosovarë u përzunë nga shtëpitë dhe u dërguan në kufirin me Shqipërinë. Prej 28 marsit 1999 në qytetin e Prizrenit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi më shtëpi, duke urdhëruar banorët shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Ata u detyruan t'u bashkoheshin kolonave të automjeteve dhe të njerëzve që udhëtonin në këmbë drejt kufirit shqiptar. Gjatë rrugës, anëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë rrahën dhe vranë meshkuj kosovarë shqiptarë, ndanë gra kosovare shqiptare nga kolona. dhe i sulmuan gratë seksualisht. Në kufi, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua morën shqiptarëve të Kosovës letërnjoftimet.

c. Skënderaj: Duke filluar më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe shkatërruan me anë të granatimeve dhe djegies fshatrat Vojnikë, Leçinë, Klladernicë, Turuçec dhe Izbicë. Shumë shtëpi, dyqane dhe xhami u shkatërruan, duke përfshirë xhaminë në qendrën e fshatit Qirez. Disa gra dhe fëmijë u morën nga anëtarë të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë dhe u mbajtën në një hambar në Qirez. Gratë iu nënshtruan sulmit seksual dhe atyre iu vodhën të hollat dhe pronat. Së paku tetë prej grave u vranë pasi u sulmuan seksualisht dhe kufomat e tyre u hodhën në tri puse në fshatin Qirez. Më 28 mars 1999 apo rreth kësaj date, së paku 4,500 shqiptarë të Kosovës prej këtyre fshatrave u mblodhën në fshatin Izbicë, ku pjesëtarët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë kërkuan të holla prej këtyre shqiptarëve të Kosovës dhe i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Më tej, një numër i madh i burrave u vranë. Gratë dhe fëmijët u çuan me dhunë si grup në drejtim të Klinës, Gjakovës dhe më në fund në kufirin me Shqipërinë.

d. Suharekë: Në mëngjesin e 25 marsit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan qytetin e Suharekës. Gjatë ditëve që pasuan, policët shkonin shtëpi më shtëpi, duke kërcënuar dhe sulmuar dhe duke vrarë banorët shqiptarë të Kosovës dhe duke nxjerrë shumë njerëz nga shtëpitë e tyre nën tytën e pushkës. Shumë shtëpive dhe dyqaneve, që ishin prona të shqiptarëve të Kosovës, iu vu zjarri dhe një xhami në Suharekë u dëmtua. Gratë, fëmijët dhe pleqtë u larguan nga policia dhe pastaj një numër burrash u vranë nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Shqiptarët e Kosovës u detyruan të iknin me kamionë, traktorë dhe rimorkio drejt kufirit me Shqipërinë. Kur po kalonin kufirin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua morën shumë prej tyre letërnjoftimet dhe të hollat.

(i) Më 31 mars 1999, rreth 80.000 shqiptarë të Kosovës të shpërngulur nga fshatrat e komunës së Suharekës u mblodhën afër Bellanicës. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e

granatuan Bellanicën, duke detyruar të shpërngulurve të iknin drejt kufirit shqiptar. Para se të kalonin kufirin, forcat e RFJ-së dhe Serbisë ua morën të gjitha letërnjoftimet.

e. Pejë: Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth këtyre datave, në qytetin e Pejës, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin shtëpi më shtëpi duke detyruar shqiptarë të Kosovës të largoheshin. Disa shtëpive iu vu zjarri dhe disa njerëz u pushkatuan. Në çdo rrugë u vendosën ushtarë dhe policë të cilët i drejtonin shqiptarët e Kosovës drejt qendrës së qytetit. Kur njerëzit erdhën në qendrën e qytetit, ata pa vetura apo mjete transporti u detyruan të hypnin nëpër autobusë apo kamionë dhe u çuan në qytetin e Prizrenit dhe pastaj drejt kufirit me Shqipërinë. Në dalje të qytetit të Prizrenit, shqiptarët e Kosovës u detyruan të zbritnin prej autobusëve dhe të ecnin rreth 15 kilometra deri në kufi, ku, para se të kalonin kufirin, u urdhëruan t'u dorëzonin letërnjoftimet forcave të RFJ-së dhe të Serbisë.

f. Mitrovicë: Duke filluar më 25 mars 1999 ose rreth kësaj date, dhe gjatë mesit të prillit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të lëviznin sistematikisht nëpër qytetin e Mitrovicës. Ata hynin nëpër shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës dhe urdhëronin banorët që t'i lëshonin menjëherë shtëpitë dhe të shkonin në stacionin e autobusëve. Disa shtëpive iu vu zjarri, kështu që banorët u detyruan të iknin në lagje të tjera të qytetit. Së paku njëra prej xhamive të qytetit u dogj dhe u dëmtua. Gjatë një periudhe trijavore, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vazhduan të dëbonin banorët shqiptarë kosovarë të qytetit. Gjatë kësaj periudhe, objektet që ishin pronë e shqiptarëve të Kosovës u shkatërruan dhe shqiptarëve kosovarë iu plaçkitën të holla, automjete dhe artikuj të tjerë me vlerë, dhe gratë shqiptare të Kosovës u sulmuan seksualisht. Metoda të ngjashme u zbatuan në fshatrat e tjera të komunës së Mitrovicës: forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i nxorën shqiptarët e Kosovës nga shtëpitë dhe i shkatërruan fshatrat. Banorët shqiptarë kosovarë të kësaj komune u detyruan t'u bashkoheshin kolonave drejt kufirit me Shqipërinë nëpër qytetet e Skënderajt, Pejës, Gjakovës dhe Prizrenit. Gjatë rrugës për në kufi, oficerët e forcave të RFJ-së dhe të Serbisë u plaçkitën artikuj me vlerë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet.

g. Prishtinë: Duke filluar më 24 mars 1999 apo rreth kësaj date dhe deri në fund të majit të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkonin në shtëpitë e shqiptarëve kosovarë në qytetin e Prishtinës dhe i detyronin banorët që të largoheshin. Gjatë këtyre dëbimeve me forcë, u vranë një numër njerëzish. Shumë prej të dëbuarve shkuan drejt në stacionin e trenit, kurse të tjerët kërkuan strehim në lagje të tjera të afërta. Qindra shqiptarë etnikë, të cilëve policët serbë ua tregonin udhën në çdo udhëkryq, u mblodhën në stacionin e trenit dhe pastaj u futën në trena dhe në autobusë të stërmbushur. Ata në tren u çuan deri në Han të Elezit, fshat afër kufirit me Maqedoninë. Gjatë rrugës për në kufi, shumë njerëzve u morën letërnjoftimet. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë shqiptarëve të Kosovës, pasi zbritën nga trenat, të ecnin nëpër binarë deri në Maqedoni, sepse toka përreth ishte e minuar. Ata që kërkonin të fshiheshin në Prishtinë u dëbuan në një mënyrë të ngjashme disa ditë më vonë. Gjatë këtyre dëbimeve me dhunë, u vranë një numër njerëzish dhe disa gra u sulmuan seksualisht.

(i) Gjatë po kësaj periudhe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatrat e komunës së Prishtinës, ku ata rrahën dhe vranë shumë shqiptarë kosovarë, duke ua plaçkitur të hollat dhe pasurinë dhe duke ua djegur shtëpitë. Shumë prej fshatarëve u çuan me kamion në

Glllogoc në komunën e Lipjanit. Nga andej hypën në tren për në Han të Elezit dhe ecën deri në kufirin me Maqedoninë. Të tjerët, pasi arritën në qytetin e Ferizajit, morën urdhra nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë të hypnin në tren për në Han të Elezit, nga kaluan në këmbë kufirin me Maqedoninë.

h. Gjakovë: Në mars të vitit 1999, popullsia e qytetit të Gjakovës ishte rritur dukshëm për shkak të ardhjes së një numri të madh njerëzish të shpërngulur brenda vendit, të cilët ishin larguar nga fshatrat e tyre për t'i ikur granatimit të qëllimshëm të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë gjatë vitit 1998 dhe për t'i ikur konfliktit të armatosur midis këtyre forcave dhe anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lëvizja e vazhdueshme e këtyre personave të shpërngulur brenda vendit u shpeshua pas datës 24 mars 1999, kur, pas dëbimeve me dhunë nga qyteti i Gjakovës, shumë njerëz të shpërngulur brenda vendit u kthyen nga qyteti i Gjakovës në fshatra përreth, por u dëbuan përsëri prej këtyre fshatrave nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Këto forca serbe kontrolluan dhe bashkërenduan lëvizjen e këtyre njerëzve të shpërngulur brenda vendit tek udhëtonin nga këto fshatra në qytetin e Gjakovës dhe anasjelltas dhe më në fund drejt kufirit midis Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë. Personat që udhëtonin në këmbë u dërguan drejtpërsedrejti nga qyteti i Gjakovës në ndonjërin prej disa vendkalimeve kufitare. Njerëzit që udhëtonin me automjete së pari iu drejtuan qytetit të Prizrenit para se t'i afroreshin kufirit dhe të kalonin kufirin me Republikën e Shqipërisë.

(i) Prej 24 marsit 1999 apo rreth kësaj date, deri më 11 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të detyronin banorët e Gjakovës të largoheshin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shpërndaheshin nëpër qytet dhe shkonin shtëpi më shtëpi, duke urdhëruar shqiptarët e Kosovës të largoheshin nga shtëpitë e tyre. Në disa raste, u vranë njerëz dhe shumë njerëz u kërcënuan me vdekje. Shumë shtëpi dhe dyqane të shqiptarëve të Kosovës u dogjën, kurse ato të serbëve u mbrojtën. Më 24 mars 1999, xhamia e vjetër në Rogovë dhe lagja historike e Gjakovës duke përfshirë çarshinë e vjetër, Xhaminë e Hadumit dhe Bibliotekën Islamike të bashkëngjitur ishin ndër disa objekte kulturore që u shkatërruan dukshëm ose plotësisht. Gjatë periudhës prej 2 deri më 4 prill 1999, mijëra shqiptarë të Kosovës, banorë të Gjakovës dhe të fshatrave përreth, iu bashkuan një kolone të gjatë njerëzish në këmbë apo me vetura, kamionë dhe traktorë, dhe shkuan në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i drejtuan të ikurit në rrugë të caktuara që më parë, dhe në postblloqe policore gjatë rrugës, letërnjoftimet dhe targat e makinave shumicës së shqiptarëve të Kosovës iu konfiskuan. Në disa raste, u perdorën kamionët e Ushtrisë Jugosllave për të çuar njerëz deri në kufirin me Shqipërinë.

(ii) Për më tepër, në fund të marsit dhe në prill të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i dëbuan me dhunë banorët shqiptarë kosovarë të shumë fshatrave të komunës së Gjakovës, duke përfshirë fshatrat Dobrosh, Korenicë dhe Mejë. Shumë prej këtyre banorëve më vonë u urdhëruan ose u lejuan të ktheheshin në vendbanimet e tyre, vetëm për t'u dëbuar përsëri nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Carragojsit, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve, duke përfshirë banorët e mbetur të fshatrave të lartpërmendura. U dislokuan një numër i madh ushtarësh dhe policësh dhe u ngritën disa postblloqe. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende

i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin, u rrëmbyën, dhe u vranë. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkëngjiteshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina dhe më në fund kaluan në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i konfiskuan letërnjoftimet e shumë shqiptarëve të Kosovës para se të kalonin kufirin.

i. Gjilan: Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshatin Përlepticë më 6 prill 1999 apo rreth kësaj date dhe u dhanë urdhër banorëve që të largoheshin. Banorët u larguan dhe u përpoqën të hynin në një fshat tjetër, por i kthyen forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Më 13 prill 1999, banorët e Përlepticës përsëri u lajmëruan se fshati duhej të zbrazej deri të nesërmen. Në mëngjesin e të nesërmes, banorët shqiptarë të Kosovës u larguan në një kolonë prej afro 500 mjetesh transporti. Pak pas largimit të banorëve, shtëpive në Përlepticë iu vu zjarri nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Në tërë komunën e Gjilanit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht i dogjën dhe shkatërruan shtëpi, dyqane, monumente kulturore dhe objekte fetare të shqiptarëve të Kosovës, duke përfshirë një xhami në Llashticë. Shqiptarët e Kosovës në fshatra të tjera në komunën e Gjilanit gjithashtu u dëbuan nga shtëpitë e tyre. Mijëra njerëz të shpërngulur nga fshatrat si Zhegër, Nosalë dhe Lladovë kërkuan strehim në fshatin Stubëll të Poshtme në komunën e Vitisë. Shumë prej këtyre njerëzve të shpërngulur nga Gjilani kaluan kufirin e Kosovës me Serbinë, ku iu nënshtruan ngacmimeve dhe keqtrajttimeve të ngjashme me ato që i përjetuan në Kosovë, para se të hynin në Maqedoni. Të tjerët shkuan drejt në Maqedoni. Kur shqiptarët kosovarë erdhën në kufirin me Maqedoninë, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ua konfiskuan letërnjoftimet.

j. Ferizaj: Gjatë periudhës prej 24 marsit deri më 14 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i granatuan dhe sulmuan fshatrat në komunën e Ferizajit, duke përfshirë fshatrat Bibë, Prelez i Muhaxherëve, Rakaj dhe Katund i Vjetër, duke vrarë një numër banorësh. Pas granatimit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në disa fshatra duke përfshirë Papazin dhe Sojevën dhe urdhëruan banorët të largoheshin. Shqiptarë kosovarë të tjerë nga Varoshi dhe Mirostola ikën nga fshatrat e tyre kur hynë forcat serbe. Pasi banorët kishin lëshuar shtëpitë e tyre, ushtarët dhe policët i dogjën ato. Personat e shpërngulur shkuan në qytetin e Ferizajit, ku shumica hypën në trenat të cilët i çuan në vendkalimin kufitar me Maqedoninë në Han të Elezit. Forcat serbe i drejtuan udhëtarët e trenave të ecnin në binarët hekurudhorë deri në kufi. Të tjerët udhëtuan në kolona prej Ferizajit deri në këtë vendkalim kufitar. Në kufi, forcat serbe ua konfiskuan letërnjoftimet.

k. Kaçanik: Prej muajit mars deri në maj të vitit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatra në komunën e Kaçanikut dhe vetë qytetin Kaçanik. Ky sulm rezultoi në shkatërrimin e shtëpive dhe të objekteve fetare, duke përfshirë, ndër të tjera, xhamitë e Kotlinës dhe të Ivajës.

(i) Më 8 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan dhe dogjën pjesërisht fshatin Kotlinë. Më 24 mars 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përsëri sulmuan Kotlinën me sisteme të armatimit të rëndë dhe ushtarë. Shumë burra, banorë të Kotlinës, ikën në pyje të afërta gjatë këtij sulmi, derisa forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë, fëmijë dhe pleqtë që të hypnin në kamionë, të cilët i çuan në qytetin e Kaçanikut. Ata për të cilët s'kishte vend nëpër kamionë u

detyruan të ecnin pas tyre drejt Kaçanikut. Një numër burrash, banorë të Kotlinës, u vranë gjatë këtij sulmi, duke përfshirë së paku 17 burra, kufomat e të cilëve u hodhën në puse. Para se të largoheshin nga Kotlina, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e dogjën pjesën e mbetur të fshatit. Shumë nga ata që mbetën gjallë ikën në Maqedoni.

(ii) Më 27 dhe 28 mars 1999 ose rreth kësaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan qytetin e Kaçanikut. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë përdoqën, arrestuan, rrahën dhe pushkatuan shumë banorë shqiptarë kosovarë të Kaçanikut. Mijëra njerëz ikën në pyje të afërta dhe më në fund kaluan më këmbë kufirin me Maqedoninë. Personat e tjerë të shpërngulur nga qyteti i Kaçanikut dhe fshatrat përreth ecën në këmbë në fshatin Stagovë, ku hypën në trena të cilat i çuan në kufirin me Maqedoninë.

(iii) Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësoresë dhe policore hynë në fshat dhe i plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, 13 civilë u vranë me armë zjarri. Pas këtij sulmi, një pjesë e madhe e popullatës së Sllatinës ikën në Maqedoni.

(iv) Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Lisnajë në komunën e Kaçanikut. Gjatë sulmit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë disa shqiptarë kosovarë, banorë të Lisnajës. Shumë banorë të Lisnajës formuan një kolonë traktorësh me rimorkio dhe ikën në Maqedoni. Banorët e tjerë ikën në fshatra të tjera ose në pyje para se të kalonin më në fund kufirin me Maqedoninë.

l. Deçan: Më 29 mars 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Beleg dhe fshatra të tjera përreth në komunën e Deçanit. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë shkuan shtëpi më shtëpi dhe u thanë fshatarëve që t'i lëshonin shtëpitë e tyre menjëherë. Pastaj këto forca plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Disa burra, gra dhe fëmijë u nxorën nga shtëpitë e tyre dhe u mbledhën në një fushë të afërt në fshatin Beleg. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan të gjithë burrat dhe gratë që të zhvisheshin dhë tërë prona e tyre personale u konfiskua. Burrat u ndanë nga gratë dhe fëmijët dhe u çuan në bodrumin e një ndërtese afër fushës. Gratë dhe fëmijët u urdhëruan që të shkonin në një ndërtesë tjetër. Gjatë natës, së paku tri gra u sulmuan seksualisht. Të nesërmen, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u thanë fshatarëve që të largoheshin nga fshati në kamionë dhe traktorë dhe të shkonin në Shqipëri.

m. Vushtrri: Më 27 mars 1999 ose rreth kësaj dite, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan të digjin shtëpi në qytetin e Vushtrrisë dhe dogjën xhaminë kryesore në këtë qytet. Më 2 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan një numër fshatrash në verilindje të qytetit të Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakofc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë shtëpi, dyqane dhe objekte fetare u dogjën plotësisht. Fshatarët, bashkë me njerëz të shpërngulur më parë nga vendbanime të tjera në komunën e Vushtrrisë, u detyruan të formonin një kolonë prej rreth 20,000 njerëzish që udhëtonin në rrugën e Grykës së Studimes, në drejtim të qytetit të Vushtrrisë. Gjatë natës së datave 2-3 maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë



përndoqën, rrahën dhe vranë afërsisht 104 shqiptarë kosovarë dhe u vodhën artikuj me vlerë shumë të tjerëve. Mijëra shqiptarë kosovarë në këtë kolonë u ndaluan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore afër qytetit të Vushtrrisë. Më 3 maj 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë në kooperativën bujqësore i ndanë burrat shqiptarë kosovarë të moshës ushtarake nga gratë, fëmijët dhe pleqtë. Gratë, fëmijët dhe pleqtë shqiptarë kosovarë u udhëzuan të shkonin në Shqipëri dhe një numër burrash shqiptarë kosovarë u detyruan të ngitnin automjete që transportonin gratë, fëmijët dhe pleqtë në kufirin me Shqipërinë. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë transportuan qindra burra shqiptarë kosovarë të moshës ushtarake nga kooperativa bujqësore në një burg në fshatin Smrekonicë. Pas disa javësh ndalimi në kushte çnjerëzore, ku iu nënshtuan rrahjeve, torturave dhe vrasjeve, shumë nga këta burra shqiptarë të Kosovës u transportuan në fshatin Zhur, afër kufirit me Shqipërinë dhe u detyruan të kalonin në Shqipëri.

Me këto veprime dhe mosveprime, **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e:

**Pika 1:** Deportim, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (d) të Statutit të Tribunalit.

## PIKA 2

### VEPRIME TË TJERA ÇNJERËZORE (TRANSFERIM I DHUNSHËM)

74. Lidhur me ata shqiptarë kosovarë të cilët u zhvendosën brenda territorit të Kosovës, Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 16-70, dhe në veçanti paragrafin 30, duke iu referuar atyre.

Me këto veprime dhe mosveprime, **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e:

**Pika 1:** Veprime të Tjera Çnjerëzore (Transferim i Dhunshëm), **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (i) të Statutit të Tribunalit.

## PIKAT 3-4 VRASJE

75. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 16-70, duke iu referuar atyre.

76. Duke filluar nga 1 janari i vitit 1999 apo rreth kësaj date dhe deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** u vranë qindra civilë shqiptarë të Kosovës dhe persona të tjera që nuk

morën pjesë aktive në luftime. Këto vrasje u bënë në mënyrë sistematike anembanë krahinës së Kosovës dhe shkaktuan vdekjen e shumë burrave, grave dhe fëmijëve. Ndër incidentet e vrasjeve në masë janë përfshirë këto:

a. Më 15 janar 1999 apo rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, fshati Reçak në komunën e Shtimjes u sulmua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Pas granatimit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë në fshat më vonë në orët e paraditës dhe filluan bastisjet shtëpi më shtëpi. Fshatarët të cilët kërkonin të iknin prej forcave të RFJ-së dhe të Serbisë u vranë kudo në fshat. Një grup prej afro 25 burrave u përpoqën të fshiheshin në një ndërtesë, por u zbuluan nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Ata u rrahën dhe pastaj u çuan në një kodër të afërt, ku u vranë me armë zjarri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë gjithsej rreth 45 shqiptarë të Kosovës në Reçak dhe rreth tij. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën A, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

b. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan dhe sulmuan fshatin Bellacërkë në komunën e Rahovecit. Shumë banorë të Bellacërkës ikën përgjatë lumit Belaja jashtë fshatit dhe u detyruan të kërkonin strehim afër një ure hekurudhore. Kur forcat e RFJ-së dhe të Serbisë iu afruan urës, ata hapën zjarr kundër një numri fshatarësh, duke vrarë 12 veta, 10 prej tyre gra dhe fëmijë. Një fëmijë dyvjeçar mbeti gjallë pas këtij incidenti. Pastaj, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan fshatarët e tjerë të dilnin nga shtrati i përroit. Në këtë moment burrat dhe djemtë më të mëdhenj u ndanë nga pleqtë, gratë dhe fëmijët e vegjël. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë pastaj urdhëruan burrat dhe djemtë më të mëdhenj të zhvisheshin dhe ua plaçkitën sistematikisht të gjithë artikujt me vlerë. Grave dhe fëmijëve u dhanë urdhër për t'u larguar drejt një fshati të afërt, të quajtur Xërxë. Një mjek nga Bellacërka u përpoq të fliste me një komandant të forcave sulmuese, por ai u vra me armë zjarri, ashtu si edhe nipi i tij. Më pas, burrat dhe djemtë më të mëdhenj e tjerë u urdhëruan të ktheheshin në shtratin e përroit. Pasi zbatuan urdhrin, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr kundër këtyre burrave dhe djemve më të mëdhenj, duke vrarë rreth 65 shqiptarë të Kosovës. Një numër burrash dhe djemsh më të mëdhenj mbetën gjallë pas këtij incidenti dhe persona të tjerë të cilët ishin fshehur në rrethinë gjithashtu e panë këtë incident. Gjithashtu, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë edhe gjashtë burra të cilët i gjetën, të fshehur në një kanal vaditës të afërt. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën B, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

c. Më 25 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatrat Krushë e Madhe dhe Krushë e Vogël në komunën e Rahovecit. Fshatarët e Krushës së Vogël u strehuan në një pyll afër Krushës së Vogël, ku patën mundësi të shihnin forcat e RFJ-së dhe të Serbisë që sistematikisht plaçkitnin dhe digjnin shtëpitë e tyre. Pastaj fshatarët u strehuan në shtëpinë e Sejdi BATUSHËS, e cila gjendet në periferi të Krushës së Vogël. Gjatë paradites së 26 marsit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i gjetën fshatarët. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan gratë dhe fëmijët të largoheshin dhe të shkonin në Shqipëri. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i ndaluan dhe kontrolluan burrat dhe djemtë dhe ua konfiskuan letërnjoftimet dhe artikujt me vlerë. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i urdhëruan burrat dhe djemtë, nën kërcënimin e vdekjes, të ecnin drejt një shtëpie të zbrazët në Krushën e Vogël. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i detyruan burrat dhe djemtë të hynin në këtë shtëpi. Kur burrat dhe djemtë ishin mbledhur brenda, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr me mitraloz mbi ta. Pas të shtënave që zgjatën disa minuta, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i vunë zjarr shtëpisë për t'i djegur kufomat. Si pasojë të pushkatimeve dhe të zjarrit, vdiqën rreth 105 burra dhe djem shqiptarë të

Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën C, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

d. Më 26 mars 1999 ose rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë e rrethuan nga afër oborrin e familjes BERISHA në Suharekë (komuna e Suharekës). Tanket zunë pozicione, të drejtuara kundër shtëpive. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë urdhëruan banorët të dilnin nga shtëpitë. U ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët dhe u vranë gjashtë anëtarë të familjes. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë çuan anëtarët e tjerë në drejtim të një kafeneje. Këta anëtarë u futën në kafene, bashkë me tri grupe të familjes së gjerë të Berishëve. Pastaj forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr kundër njerëzve aty brenda. Në kafene u hodhën edhe lëndë shpërthyesë. Në këtë aksion u vranë së paku 44 civilë dhe u plagosën rëndë edhe të tjerë. Kufomat e viktimave u vendosën në platformën e një kamioni, i cili pastaj u nis në drejtim të Prizrenit. Tre individë të plagosur, të cilët u hodhën në kamion bashkë me kufomat, kërcyen prej kamionit gjatë rrugës për në Prizren. Mbetjet njerëzore nga vrasja e familjes BERISHA janë gjetur ndërkohë në dy vende: së pari në një poligon në komunën e Prizrenit dhe së dyti në një vendvarrim masiv në qendrën e stërvitjes të SAJ-ve në Batajnicë afër Beogradit në Serbi. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën D, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

e. Më 26 mars 1999 apo rreth kësaj date, në orët e mëngjesit, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Padalishtë të komunës së Istogut. Ndërkohë që po hynin në fshat, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëlluan mbi shtëpitë dhe mbi fshatarët që përpiqeshin të iknin. Tetë anëtarë të familjes së Bekë IMERAJT u dëbuan me forcë nga shtëpia dhe u vranë para shtëpisë së vet. Banorë të tjerë të Padalishtës u vranë në shtëpitë e tyre dhe në një shtrat përroi afër fshatit. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë gjithsej afro 20 shqiptarë të Kosovës nga Padalishta. (Të vrarët që dihen me emër janë radhitur në Listën E, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

f. Më 27 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë granatuan fshatin Izbicë në komunën e Skënderajt me sisteme të armatimit të rëndë. Së paku 4,500 fshatarë nga Izbica dhe fshatrat përreth u strehuan në një lëndinë në Izbicë. Më 28 marsit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatarët dhe iu afruan atyre, duke u kërkuar para. Pasi forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u vodhën fshatarëve artikujt me vlerë, i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët e vegjël. Meshkujt pastaj u ndanë në dy grupe. Njëri grup u dërgua në një kodër të afërt kurse tjetri u dërgua në shtratin e një përroi të afërt. Pastaj, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë qëlluan mbi të dyja grupet e burrave dhe rreth 116 shqiptarë të Kosovës u vranë. Gjithashtu më 28 mars 1999, gratë dhe fëmijët që ishin mbledhur në Izbicë u detyruan të largoheshin dhe të ecnin në këmbë drejt Shqipërisë. Dy plaka invalide ishin ulur në rimorkion e një traktori dhe nuk mund të ecnin. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i vunë zjarrin rimorkios dhe të dyja plakat u dogjën të gjalla. (Të vrarët në Izbicë që dihen me emër janë radhitur në Listën F që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

g. Në orët e vona të mbrëmjes të datës 1 prill 1999 ose rreth asaj kohe, dhe duke vazhduar në orët e hershme të mëngjesit të 2 prillit 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një aksion kundër lagjes Qerimi të Gjakovës. Gjatë një periudhe prej disa orësh, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hynë me forcë në shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës në lagjen Qerimi, vranë banorët dhe u vunë zjarr shtëpive. Dhjetëra shtëpi u shkatërruan dhe mbi 50 persona u vranë. Për shembull, në një shtëpi në Rrugën Millosh Gilliq Nr. 157, forcat e

RFJ-së dhe të Serbisë pushkatuan njerëzit që ishin brenda dhe pastaj i vunë zjarr shtëpisë. Si pasojë e pushkatimeve dhe të zjarreve të ndezura nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vetëm në këtë vend, u vranë 20 shqiptarë të Kosovës, duke përfshirë 19 gra dhe fëmijë. (Emrat e të vrarëve në këtë vend janë radhitur në Listën G, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

h. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 27 prill 1999 ose rreth asaj kohe, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë filluan një sulm masiv kundër popullatës shqiptare kosovare të luginave të Carragojsit, Erenikut dhe Travës (komuna e Gjakovës) për të dëbuar popullatën prej kësaj treve. U dislokuan një numër i madh forcash të RFJ-së dhe të Serbisë dhe u ngritën disa postblloqe. Gjatë tërë ditës, fshatarët e kërcënuar drejtpërsëdrejti nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë dilnin nga shtëpitë e tyre dhe u bashkoheshin disa kolonave të refugjatëve me traktorë, qerre me kuaj dhe makina. Në Mejë, Korenicë dhe Orizë, një numër i madh dhe ende i pacaktuar burrash civilë, shqiptarë të Kosovës, u ndanë nga turma e fshatarëve që po iknin dhe u rrëmbyen. Shumë prej këtyre burrave u ekzekutuan menjëherë, dhe rreth 300 persona ende mungojnë. Dokumentet personale të së paku shtatë personave dhe mbetje njerëzore të shumë prej 300 personave të cilët u panë për herë të fundit në Mejë më 27 prill 1999 në një varr masiv të fshehur u gjetën në qendrën e stërvitjes të "SAJ"-ve në Batajnicë afër Beogradit në Serbi. (Emrat e të vrarëve janë radhitur në Listën H, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

i. Më 2 maj 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan disa fshatra në verilindje të qytetit të Vushtrrisë, duke përfshirë fshatrat Skromë, Sllakoc, Ceceli dhe Studime e Epërme. Fshatarët u dëbuan nga shtëpitë e tyre dhe shumë prej shtëpive, dyqaneve dhe objekteve fetare të tyre u dogjën plotësisht. Me vonë u radhitën me forcë në një kolonë prej rreth 20,000 njerëzve, e cila u nis në rrugën e grykës së Studimes, drejt qytetit të Vushtrrisë. Gjatë këtyre veprimeve, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ngacmuan, rrahën dhe plaçkitën shqiptarë kosovarë që udhëtonin në kolonë dhe vranë rreth 104 shqiptarë të Kosovës. (Të vrarët, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën I, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

j. Më 22 maj 1999 ose rreth kësaj date, në orët e hershme të mëngjesit, një person në uniformë në kompleksin e Burgut të Dubravës (komuna e Istogut) lajmëroi prej kullës së vrojtimit se të gjithë të burgosurit duhej të mblidhnin plaçkat e tyre personale dhe të radhiteshin në fushën e sportit në kompleksin e burgut për transferim në burgun e Nishit në Serbi. Brenda një kohe shumë të shkurtër, qindra të burgosur u mblodhën në fushën e sportit me plaçkat e tyre në çanta dhe u radhitën për të pritur transportim. Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hapën zjarr pa paralajmërim kundër të burgosurve prej kullës së vrojtimit, prej vrimave në murin rrethues dhe prej foleve të zjarrit jashtë murit. Shumë të burgosur u vranë menjëherë dhe të tjerë u plagosën.

(i) Më 23 maj ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë hodhën granata dhe qëlluan në kanalet e shkarkimit, kanalet e ujërave të zeza, në godina dhe bodrume, duke vrarë dhe plagosur shumë të burgosur të tjerë të cilët kishin kërkuar strehim në këto vende pas ngjarjeve të ditës së mëparshme. U vranë gjithsej rreth 50 të burgosur. (Shumë prej të burgosurve të vrarë mbetën të paidentifikuar. Mirëpo, emrat e personave që dihen të jenë vrarë janë radhitur në Listën J, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

k. Midis muajve mars dhe maj 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërморën një sërë ofensivash masive kundër disa fshatrave në komunën e Kaçanikut, të cilat shkaktuan vdekjen e më shumë se njëqind civilëve.

(i) Më 24 mars 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sulmuan fshatin Kotlinë. Gjatë sulmit, shumica e shtëpive u dogjën dhe se paku 17 persona u vranë. Disa prej këtyre të vranëve u kapën në pyll, u ekzekutuan dhe u hodhën në puse. Në puse u hodhën lëndë shpërthyes.

(ii) Më 13 prill 1999 apo rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Sllatinë dhe lagjen e Vatës. Pasi granatuan fshatin, trupat e këmbësorisë dhe ato policore hynë në fshat dhe plaçkitën dhe dogjën shtëpitë. Gjatë këtij aksioni, u vranë me armë zjarri 13 civilë.

(iii) Më 21 maj 1999 ose rreth kësaj date, fshati Stagovë u rrethua nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë. Popullata u përpoq të ikte drejt maleve në lindje të fshatit. Gjatë këtij aksioni, u vranë së paku 12 persona. Pjesa më e madhe e fshatit u plaçkit dhe u dogj.

(iv) Më 25 maj 1999 ose rreth kësaj date, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë rrethuan fshatin Lisnajë. Kur forcat hynë në fshat, popullatës iu dha urdhri që të mbliidhej në shkollë dhe të largohej nga fshati me traktorë. Pastaj u ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Gjatë këtij aksioni, u vranë 4 burra. Gjithashtu, 4 anëtarë të familjes Qorri u vranë në përpjekje për të ikur drejt pyjeve. (Personat e vranë në komunën e Kaçanikut, emrat e të cilëve dihen, janë radhitur në Listën K, që i bashkëngjitet kësaj aktakuze si shtojcë.)

Me këto veprime dhe mosveprime, **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e:

**Pika 3:** Vrasje, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (a) të Statutit të Tribunalit.

**Pika 4:** Vrasje, **SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS**, e ndëshkueshme në bazë të Nenit 3 të Statutit të Tribunalit dhe e njohur në Nenin 3 (1) (a) (vrasje) të Konventave të Gjenevës.

## PIKA 5

### PËRNDJEKJE

77. Prokurorja riparaqet dhe përfshin paragrafet 16-70 dhe 76, duke iu referuar atyre.

78. Duke filluar më 1 janar të vitit 1999 apo rreth kësaj date dhe deri më 20 qershor 1999, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, duke vepruar nën drejtimin, me nxitjen apo me përkrahjen e **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** shfrytëzuan mjetet dhe metodat e përshkruara në paragrafet 26 deri në 33 për të kryer një fushatë përndjekjeje kundër popullatës shqiptare të Kosovës, duke përfshirë civilë shqiptarë të Kosovës, për arsye politike, racore ose fetare. Çdo i akuzuar synonte që fushata të godiste popullatën shqiptare të Kosovës për arsye politike, racore ose fetare, gjë që del e qartë ndër të tjera nga fakti se pjesa dërmuese e viktimave të krimeve ishin shqiptarë të Kosovës të besimit mysliman si dhe nga përdorimi i përhapur i fjalëve fyese në Kosovë. Në këto përndjekje përfshiheshin ndër të tjera këto metoda:

- a. Transferimi dhe dëbimi i dhunshëm nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë i rreth 800,000 civilëve shqiptarë kosovarë, përshkruar në paragrafet 26-33.
- b. Vrasja e qindra civilëve shqiptarë kosovarë dhe personave të tjerë që nuk morën pjesë aktive në luftime, nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, përshkruar në paragrafet 28-29.
- c. Sulmi seksual nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndaj shqiptarëve kosovarë, veçanërisht grave, duke përfshirë sulmet seksuale të përshkruara në paragrafet 26 dhe 28.
- d. Shkatërrimi apo dëmtimi kuturu i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë. Gjatë dhe pas sulmeve mbi qytetet dhe fshatrat, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë sistematikisht dëmtuan dhe shkatërruan monumente kulturore dhe vende të shenjta myslimane. Xhamitë janë granatuar, djegur dhe hedhur në erë me dinamit anembanë krahinës. Të përfshira ndër këto incidente janë: dëmtimi dhe/ose shkatërrimi i xhamive në Vushtri, Suharekë, Celinë, Rogovë, Bellacërkë, Qirez, Kotlinë, Ivajë, Brestofc. Krushë të Madhe, Mitrovicë, Llashticë, Landovicë, Gjakovë, përshkruar në paragrafin 73.

Me këto veprime dhe mosveprime, **MILLAN MILLUTINOVIQI, NIKOLLA SHAINOVIQI, DRAGOLUB OJDANIQI, NEBOJSHA PAVKOVIQI, VLADIMIR LLAZAREVIQI, VLASTIMIR GJORGJEVIQI** dhe **SRETEN LLUKIQI** planifikuan, nxitën, urdhëruan, kryen apo në mënyra të tjera ndihmuan planifikimin, përgatitjen apo kryerjen e veprimeve me sa vijon:

**Pika 5:** Përndjekjet për arsye politike, racore ose fetare, **KRIM KUNDËR NJERËZIMIT**, i ndëshkueshëm në bazë të Nenit 5 (h) të Statutit të Tribunalit.

#### **AKUZA TË PËRGJITHSHME**

79. Gjatë tërë kohës që lidhet me këtë aktakuzë ka ekzistuar një gjendje e konfliktit të armatosur në Kosovë, në RFJ.

80. Të gjitha veprimet dhe mosveprimet që cilësohen si krime kundër njerëzimit ishin pjesë të një sulmi të gjerë dhe sistematik kundër popullatës civile shqiptare të Kosovës dhe personave të tjera që nuk morën pjesë aktive në luftime.

#### **SFONDI DHE KONTEKSTI I AKUZAVE**

81. Kosova gjendet në pjesën jugore të Republikës së Serbisë, republikë përbërëse e Serbisë dhe Malit të Zi ("SMZ"). Territori i tashëm i SMZ-së ishte pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ"). Kosova kufizohet në veri dhe veriperëndim me Republikën e Malit të Zi, në jugperëndim me Republikën e Shqipërisë ("Shqipëria"), kurse në jug me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ("Maqedonia"). Kryeqyteti i Kosovës është Prishtina.

82. Në regjistrimin e popullsisë të vitit 1981, regjistrimi i fundit me pjesëmarrje pothuajse të plotë, Kosova kishte përafërsisht 1,585,000 banorë, prej të cilëve 77 për qind ishin shqiptarë, ndërsa 13 për qind ishin serbë. Shqiptarët e Kosovës bojkotuan regjistrimin e popullsisë të organizuar në vitin 1991, por sipas vlerësimeve të përgjithshme për popullsinë gjatë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, Kosova ishte rreth 85-90 për qind shqiptare dhe 5-10 për qind serbe.

83. Në vitin 1974, Kushtetuta e re e RSFJ-së parashihte decentralizimin e pushtetit qendror në të gjashtë republikat përbërëse të vendit. Brenda Serbisë, Kosova dhe Vojvodina fituan autonomi të gjerë, duke përfshirë kontrollin e sistemeve të tyre arsimore, të gjykatave dhe të policisë. Ato përfaqësoheshin në Kuvendin, Gjykatën Kushtetuese dhe Kryesinë e RSFJ-së.

84. Gjatë viteve 80, serbët shprehën shqetësime për diskriminimin e tyre nga qeveria krahinore e udhëhequr nga shqiptarët e Kosovës. Në të njëjtën kohë, shqiptarët e Kosovës shprehën shqetësime lidhur me zhvillimin e pakët ekonomik dhe kërkuan liberalizimin politik dhe statusin e republikës për Kosovën. Që nga viti 1981, shqiptarët e Kosovës organizuan demonstrata, që u shtypën nga Ushtria e RSFJ-së dhe forcat policore të Serbisë.

